

MA FILOZOFI

1. VLERËSIMI I PROGRAMIT: Filozofi MA

1.1. Misioni, objektivat dhe administrimi

Pasqyra e përmbajtjes së programit

Emri i programit të studimit	Master në Filozofi
KKK Niveli (me shkurtesat BA, MA, PhD, program doktrate, kurs universitar, certifikatë apo diplomë profesionale)	MA, (Niveli 7/KKK/KEK-Arsimi i Lartë-cikli i 2- të i Bolonjës (Masteri)-Shkalla Master (A)
Grada akademike dhe emërtimi i diplomës në formë të plotë dhe të shkurtuar	Master në Filozofi (MA)
Fusha e studimit sipas Erasmus Subject Area Codes (ESAC)	08.1
Profili i programit akademik	Shkencor
Kohëzgjatja minimale e studimit	Dy vite akademike, katër semestra.
Forma e studimit (e rregullt, pa shkëputje nga puna, studim në distancë etj.)	Studim i rregullt
Numri i ECTS kredive (total dhe për vit)	Numri total i kredive (ECTS) të akumuluarra nnpër një vit është 60 ECTS – kredi.
Modulet/Kurset	Viti I, Semestri I Logjikë (O) Konceptet filozofike të Platonit dhe Aristotelit (O) Filozofi e shkencës dhe metodologji (O) Politika, religjioni dhe kultura (O) Shkrim akademik në filozofi (O) Viti I, Semestri II Problemet kryesore të filozofisë moderne (O) Teori e njohjes (O)

	Hermeneutika filozofike (O) Arti dhe shoqëria (O) Filozofi e gjuhës (Z) Frege (Z) Viti II, Semestri III Filozofi e moralit (O) Filozofi sociale (O) Autorët e përzgjedhur nga filozofia bashkëkohore (O) Teoritë kritike bashkëkohore (Z) Filozofi e të drejtave të njeriut (Z) Filozofi e arkitekturës (Z) Filozofi e mediave (Z) Viti II, Semestri IV Punim i temës së masterit										
Numri i studentëve për regjistrim	40										
Personi përgjegjës i programit	Prof. Ass. Dr. Hasnije Ilazi										
Stafi i përhershëm ¹ (numri sipas kategorive të personelit)	<table border="1"> <tr> <td>Prof. dr.</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Prof. asoc. dr.</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof. ass. dr.</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>PhD.</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>MA.</td> <td>0</td> </tr> </table>	Prof. dr.	0	Prof. asoc. dr.	1	Prof. ass. dr.	5	PhD.	1	MA.	0
Prof. dr.	0										
Prof. asoc. dr.	1										
Prof. ass. dr.	5										
PhD.	1										
MA.	0										
Kostoja e studimit	Sipas Statutit të Universitetit të Prishtinës.										

Standardi 1.1. Misioni i programit të studimit është në përputhje me deklaratën e përgjithshme të misionit të institucionit.

Misioni i këtij programi është në harmoni të plotë me misionin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, të deklaruar edhe në aktin më të lartë juridik të tij – Statutin.

Standardi 1.2. Këshilla relevante akademike dhe profesionale merren parasysh kur përcaktohen rezultatet e synuara të mësimin të cilat janë në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe Kornizën për Kualifikimet në Hapsirën Europiane të Arsimit të Lartë.

¹ - Fakulteti angazhon me konkurs publik çdo vit një staf të jashtëm akademik me thirrje së paku MA ose doktoranda që mbajnë ushtrimet në lëndët përkatëse, që zakonisht janë 5-7 veta staf junior me kontratë njëvjeçare.

- Prof. Dr. Kadri Metaj që ishte profesor në Departamentin e Filozofisë, nga fundi i semestrit veror 2019 është i pensuar, por është i paraparë për angazhim në Departament për 5 vite me radhë për të mbajtur 4 orë në këtë program.

Dokumentet relevante në të cilat është mbështetur programi janë në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve, sipas së cilës ky program studimi i takon nivelit 7 të saj. Po ashtu, kjo fushë studimi është në përputhje edhe me Erasmus Subject Area Codes (ESAC) pika 08.1.

Standardi 1.3. Programi i studimit ka një koncept të mirë-përcaktuar didaktik dhe kërkimor.

Programi është i ndërtuar me qëllim të thellimit të njohurive të studentëve për fushën e studimit dhe përfshin metoda relevante didaktike të këtij niveli të studimit. Koncepti dhe qëllimi i programit konsiston në:

- Arsimimin dhe edukimin e studentëve në fushën e filozofisë, duke zhvilluar dhe afirmuar teoritë dhe koncepte kryesore filozofike dhe duke promovuar studimin dhe hulumtimin në këtë fushë;
- Zhvillimin e mendimit kritik dhe kreativ mbi traditën filozofike dhe mbi çështjet të domethënëse për botën e sotme;
- Zhvillimin e burimeve njerëzore për aplikimin e të arriturave teorike dhe filozofike në jetën praktike;
- Krijimi i kapaciteteve profesionale dhe intelektuale, të afta të marrin përgjegjësi qytetare mbi proceset shoqërore (politike, sociale, kulturore, arsimore, ambientale etj.) në Kosovë;
- Kompletimin e formulës akademike të Bolonjës 3+2 (BA+MA).
- Mundësia për vazhdimin e shkollimit në nivelin PhD.

Standardi 1.4. Ekzistojnë politika formale, udhëzime dhe rregullore që kanë të bëjnë me çështje të përsëritura procedurale ose akademike. Këto janë bërë publike për të gjithë stafin dhe studentët.

Politikat formale, udhëzimet, rregulloret që kanë të bëjnë me çështjet procedurale siç janë:

Ligji për Arsimin e Lartë i Republikës së Kosovës, 2010;

Statuti i Universitetit të Prishtinës;

Rregullorja e zgjedhjes dhe ri-zgjedhjes dhe avancimit të stafit akademik;

Kodi etik;

Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës 2017 – 2021,

janë të qasshme për të gjithë në ueb faqen e Universitetit (Linku: <https://www.uni-pr.edu/>).

Kurse:

Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit Filozofik 2018/2023;

Rregullorja e Studimeve Master;

Syllabuset, e dokumentet tjera relevante janë publike në gjuhën shqipe dhe disa në gjuhën angleze në ueb faqen e Fakultetit Filozofik (Linku: <http://filozofiku.uni-pr.edu/>).

Standardi 1.5. I gjithë stafi dhe studentët janë në përputhje me rregulloret e brendshme që kanë të bëjnë me sjelljen etike në hulumtim, mësimdhënie dhe vlerësim në të gjitha aktivitetet akademike dhe administrative.

Rregulloret e brendshme dhe aktet tjera që rregullojnë raportet ndërmjet stafit dhe ndërmjet stafit dhe studentëve janë të qasshme për të gjithë në ueb faqen e fakultetit.

Standardi 1.6. Të gjitha politikat, rregulloret, termat e referencës dhe deklaratat e përgjegjësisë në lidhje me menaxhimin dhe shpërndarjen e programit rishikohen së paku një herë në dy vjet dhe ndryshohen sipas nevojës në rrethanat të caktuara ndryshimi.

Politikat që përfshijnë rregulloret dhe aktet tjera nënligjore që lidhen me programin e studimeve, por edhe me programet tjera të studimit, monitorohen nga mekanizmat adekuat të Fakultetit dhe Universitetit siç janë: Koordinatorin i Sigurimit të Cilësisë në nivel Fakulteti, Prodekani për Mësim, Këshilli i Fakultetit, Prorektori për Mësim, Senati e mekanizma të tjerë, që për ndryshimet eventuale marrin vendime konform kompetencave të tyre.

SWOT analiza për misionin, objektivat dhe administrimin:

A. Pikat e forta

- Stafit akademik është i përgatitur nga pikëpamja edukativo-shkencore dhe një gjuhët e huaja (anglisht, gjermanisht, kroatisht, frëngjisht).
- Program i krahasueshëm me programet e masterit në filozofi në vendet perëndimore.
- Infrastruktura përcjellëse e mjaftueshme.
- Interesimi i madh i kandidatëve për studime master në filozofi, në veçanti duhet theksuar interesimi i madh i kandidatëve edhe nga fushat tjera.
- Administrimi funksional
- Ndërkombëtarizimi i departamentit (përfshirja e Departamentit në programet e bashkimit evropian dhe më gjerë si CEEPUS, ERASMUS+, etj.)
- Organizimi dhe pjesëmarrja në konferencat ndërkombëtare (Dita botërore e filozofisë shënohet nga Departamenti i Filozofisë në bashkëveprim me Shoqatën e Filzofëve të Kosovës çdo vit për 10 vite me radhë deri tani dhe në vazhdimësi)
- Publikimet e stafit dhe e studentëve master nëpër revista ekzistuese shkencore në vend dhe jashtë vendit

B. Dobësitë

- Stafit i pamjaftueshëm
- Mungesa e literaturës në gjuhën e studimit
- Vështirësitë në plotësimin e kriterëve për ndërkombëtarizimin e revista filozofike albanofone si Revistat “Agora philosophia”, “Njohja” (Vendosja e tyre si në platformat SCOPUS, Web of Science etj.)
- Mungesa e njohurive të gjuhëve të huaja nga ana e studentëve

- Mungesa përkatësisht pamjaftueshëmria e fondeve dhe jofleksibiliteti procedural për ftesën dhe pagesën e bashkëpunëtorëve të jashtëm ndërkombëtar për mbajtjen e lëndëve brenda kurrikulës

C. Mundësitë

- Hapja e konkursit për stafin e ri dhe avancimin e stafit aktual në përputhje me Strategjinë e Zhvillimi të Fakultetit Filozofik 2018/2023, ku parashihet që në këtë interval kohor në Departamentin e Filozofisë të ketë punësi dhe ose avancim 3 profesorë dhe 4 asistentë.
- Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar
- Publikimet e stafit dhe e studentëve master nëpër revista ekzistuese shkencore në vend dhe jashtë vendit

D. Sfidat

- Mungesa e buxhetit për hapjen e vendeve të reja të punës
- Mungesa e buxhetit për pajisjen me literaturë
- Rritja e cilësisë në përputhje me standarde ndërkombëtare
- Mungesa e politikave të mirëfillta për avancimin profesional të stafit akademik përmes pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare dhe publikimeve nëpër revista ndërkombëtare
- Mungesa e fondeve për mbajtje të ligjëratave e prezantimeve nga profesorët ndërkombëtarë
- Mungesa e fondeve përkatësisht menaxhimi i keq i fondeve si pasojë e të cilin stafi akademik që bën punë shtesë administrative, nuk paguhet për këtë punë (aplikacione për projekte ndërkombëtare, aplikacione për akreditime të programeve etj.)
- Aktiviteti shtesë profesional i stafit akademik (ku dihet sa kohë dhe energji shpenzohet në këtë aktivitet) nuk poentohet fare dhe si pasojë nuk vlen për avancimin e tij akademik
- Vlerësimi i stafit akademik për avancim nuk është në përputhje me misionin e Universitetit të përcaktuar me statutin e UP-së kun ë rend të parë promovohet mësimdhënia dhe pastaj edhe puna shkencore. Vlerësimi i performancës në mësimdhënie ka vlerë minimale për avancim akademik.

Treguesi i performancës 1.1. Institucioni ka vendosur Treguesit Kryesorë të Performancës (TKP) në nivelin e programit të studimit. Të dhënat që ofrohen, rishikohen të paktën një herë në vit me performancën e përgjithshme të raportuar tek strukturat vendimmarrëse.

Përmes Rregullores nr 4-132, të datës 30.12.2016, institucioni ka vendosur Treguesit Kryesorë të Performancës edhe për nivelet e programeve të studimit. Këta treguesë performance maten përmes formave të përcaktuara në këtë rregullore.

Treguesi i performancës 1.2. Sistemet janë themeluar për regjistrimin qendror dhe analizën e përfundimit të kursit, progresin e programit, normat e përfundimit dhe vlerësimet e programit, me përmbledhje dhe të dhëna krahasuese të shpërndara automatikisht tek administratorët e lartë dhe komisionet përkatëse të paktën një herë në vit.

Raportimi për përfundimin e kurseve dhe mbarëvajtjen e programit bëhet nga secili mësues përmes deklaratimit të rezultateve në Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Studentëve dhe autoritete relevante brenda hirerkisë kanë qasje të drejtpërdrejtë në të dhëna statistikore të cilat tregojnë përmbledhje dhe analizë të rezultateve të kurseve të mbajtura.

Treguesi i performancës 1.3. Politikat dhe procedurat përfshijnë veprimet që duhen ndërmarrë për të trajtuar situatat ku standardet e arritshmërisë së studentëve janë të pamjaftueshme ose vlerësohen në mënyrë jokonsistente.

Politikat që përfshijnë standardet e arritjes së studentëve janë të rregulluara në nivel universiteti, duke filluar nga Statuti e deri te rregulloret e studimeve. Në raste të veçanta kur standardet e arritjes janë të papërshtatshme, inicohet rishikimi i rregulloreve dhe vendimeve në nivel universiteti.

Treguesi i performancës 1.4. Të dhënat statistikore mbi treguesit, duke përfshirë shpërndarjet e notave, normat e progresit dhe përfundimit mbahen në një bazë të dhënash qendrore të qasshme dhe rishikohet dhe raportohet rregullisht në raportet programore periodike.

Të dhënat statistikore menaxhohen nga Universiteti në bazë të legjislacionit në fuqi të Universitetit të Prishtinës.

Treguesi i performancës 1.5. Koncepti i drejtësisë gjinore dhe promovimi i mundësive të barabarta për studentë në situata të veçanta të tilla si, për shembull, studentët me probleme shëndetësore, studentët që kanë fëmijë, studentët që vijnë nga jashtë, studentët emigrantë dhe ose studentët që vijnë nga familjeve me pamundësi financiare për shkollim, vihen në praktikë në nivelin e programit të studimit.

Në pajtim me Statutin e Universitetit të Prishtinës programi i studimeve respekton barazinë gjinore, mos-diskriminimin, parimet e ndershmërisë, Kodin Etik, si dhe të kultivon, promovon frymën e humanizmit dhe gjithëpërfshirjes.

Mirëpo, infrastruktura përcjellëse në ambientet e UP është larg standardeve ndërkombëtare. Larmia e studentëve nga aspekti i gjinisë, punësimit, familjes, nacionalitetit etj. është evidente dhe është pasuri e departamentit.

Vlen të shtohet se programi i studimeve master në filozofi ofron lëndë (Filozofia e të drejtave të njeriut, Filozofi e moralit, Filozofi sociale) që promovojnë parimet në fjalë.

1.2 Menaxhimi i cilësisë

Standardi 2.1. I gjithë stafi merr pjesë në vetë-vlerësime dhe bashkëpunon me proceset e raportimit dhe përmirësimit në sferën e tyre të veprimtarisë.

Departamenti ka takimet e rregullta mujore dhe aty reflekton, diskuton dhe merr hapat e nevojshëm për përmirësimin e veprimtarinë profesionale të stafit të vet.

Standardi 2.2. Proceset e vlerësimit dhe planifikimi për përmirësim janë integruar në proceset normale të planifikimit.

Departamenti bën planet për përmirësimin e programeve e veta konform Statutit të UP-së dhe legjislacionit përcjellës të tij, Strategjisë për Zhvillim të Fakultetit Filozofik, procedurave të rregullta të akreditimit dhe riakreditimit të programeve, dhe nevojave të Departamentit si dhe në përputhje me proceset dhe kërkesat e shoqërisë.

Standardi 2.3. Proceset e sigurimit të cilësisë merren me të gjitha aspektet e planifikimit dhe ofrimit të programeve, duke përfshirë shërbimet dhe burimet e siguruara nga pjesë të tjera të institucionit.

Departamenti inicon dhe bën ndryshimet brenda programeve në koordinim me Këshillin e Fakultetit dhe Menaxhmentin e Fakultetit Filozofik dhe në përputhje me rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.

Standardi 2.4. Vlerësimet e cilësisë ofrojnë një pasqyrë të çështjeve të cilësisë për programin e përgjithshëm si dhe të komponentëve të ndryshëm brenda tij; vlerësimet i konsiderojnë inputet, proceset dhe rezultatet, me vëmendje të veçantë dhënë rezultateve të mësimit për studentët.

Vlerësimi i cilësisë së Departamentit përfshin dhe merr parasysh pasqyrën e rezultateve të mësimit dhe notimit të studentëve si dhe rezultatet e *Pyetësorit të Vlerësimit të Cilësisë*, i cili për studentët është disponueshëm online në Sistemin Elektronik për Menaxhimin e Studentëve (SEMS). Menaxhmenti i Fakultetit Filozofik ia komunikon rezultatet e Pyetësorit stafit akademik në mënyrë individuale.

Standardi 2.5. Proceset e sigurimit të cilësisë sigurojnë se janë përmbushur standardet e kërkuara dhe se ka përmirësim të vazhdueshëm të performancës.

Departamenti i Filozofisë në çdo akreditim e riakreditim i ka respektuar rekomandimet e kërkuara për arritjen e standardeve nga ekspertët ndërkombëtare të akreditimit.²

Standardi 2.6. Të dhënat e anketimit janë duke u mbledhur nga studentët, të diplomuarit dhe punëdhënësit; rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” çdo vit akademik përgatit pyetësorë në formë elektronike për studentë përmes programit SEMS, përmes të cilëve bën matje të cilësisë, ankesave, sugjerimeve apo kërkesave të studentëve mbi performancën e stafit akademik. Secili mësimdhënës individualisht dhe menaxhmenti i Fakultetit dhe i Universitetit kanë qasje në rezultatet e anketimit sa i përket lëndëve që i ofron mësimdhënësi. Megjithatë, përqindja tejet e ulët e studentëve pjesëmarrës në anketë nuk tregon rezultatet reale të vlerësimit të cilësisë.

Standardi 2.7. Rezultatet e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë janë marrë parasysh për zhvillimin e mëtejshëm të programit të studimit. Kjo përfshin rezultatet e vlerësimit, ngarkesën e studentëve, suksesin akademik dhe punësimin e të diplomuarve.

Departamenti i Filozofisë merr parasysh raportet e vlerësimit (raportet e ekspertëve ndërkombëtarë, rezultatet e anketave, informatat joformale mbi punësimin, rishikimin e ngarkesës përmes sistemit ECTS etj.) si udhërrëfyes për përmirësimin e cilësisë.

Standardi 2.8. Institucioni siguron që raportet mbi cilësinë e përgjithshme të programit përgatiten në mënyrë periodike (p.sh. çdo tre vjet) për shqyrtim brenda institucionit duke treguar forcën dhe dobësitë e tij.

Departamenti i Filozofisë reflekton në periudha kohore së paku trevjeçare të akreditimit dhe riakreditimit dhe rishikimit të planit të aktiviteteve në implementimin e Strategjisë për Zhvillimin e Fakultetit Filozofik.

Standardi 2.9. Marrëveshjet e sigurimit të cilësisë për programin vetë vlerësohen dhe përmirësohen rregullisht.

Departamenti i Filozofisë në përputhje me Rregulloren e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit në Universitetin e Prishtinës (dt. 30.12.2016) dhe Strategjinë për Zhvillimin e Fakultetit Filozofik ndërmerr veprime me qëllim që të:

- zbatojë obligimet nga korniza ligjore në fuqi për mekanizmat dhe aktivitetet për sigurimin e cilësisë dhe bashkëpunon ngushtë me akterët relevantë në këtë drejtim;
- rrisë efikasitetin në zbatimin e rekomandimeve të ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit;

²Rekomandimet dhe veprimet e ndërmarra nga Departamenti gjenden në aneks të këtij dokumenti.

- përditësojë programin në riakreditim në përputhje me mësimet e mësuara (lessons learned) dhe praktikatat më të mira;
- përmirësojë procesin e vlerësimit të brendshëm të mësimdhënies dhe programit;
- përmirësojë komunikimin dhe llogaridhënien e brendshme në raport me obligimet e secilit anëtar të Departamentit;

2.2.1 SWOT analiza për menaxhimin e cilësisë:

A. Pikat e forta

- Tradita dhjetëra vjeçare e Departamentit është një pikë e fortë. Departamenti siguron cilësinë përmes procesit të akreditimit qysh një dekadë.
- Stafii me përvojë të gjatë pedagogjike dhe kërkimore, me studime së paku të doktoratës jashtë vendit.
- Instancat dhe mekanizmat përkatës menaxherialë; resurset adekuate administrative dhe kadrovike; si dhe infrastruktura e nevojshme dhe e duhur ligjore;
- Komunikimi gjithnjë e më i mirë ndërmjet menaxhmentit, profesorëve, administratës dhe studentëve;
- Përdorimi i SEMS-it, si formë digjitale dhe e depersonalizuar e vlerësimit duke garantuar anonimitet të plotë të studentit;
- Përdorimi i teknologjive bashkëkohore si mjete konkretizuese në mësimdhënie;
- Rifreskimi i syllabuseve përkatësisht riakreditimi i programit ku merret parasysh literatura e fundit.
- Respektimi i rekomandimeve nga Zyra e Cilësisë e Universitetit të Prishtinës.
- Respektimi i rekomandimeve nga ana e ekspertëve të jashtëm të akreditimit.
- Bashkëpunimi i ngushtë me Koordinatorin për Zhvillim Akademik dhe Dekanatin e Fakultetit Filozofik për respektimin e rregullave dhe praktikave të mira për menaxhimin e cilësisë.

B. Dobësitë

- Jo i gjithë stafi administrativ dhe ai akademik kanë njohuritë e duhura që mund të përdoren në favor të ngritjes së cilësisë;
- Interesimi i dobët i studentëve për t'u angazhuar në procedurat për sigurimin e cilësisë, si p.sh. mungesa e seriozitetit në plotësimin e formularëve, mungesa e vullnetit për t'u anketuar etj.
- Nganjëherë stafi akademik nuk informohet me rezultatet e vlerësimeve të studentëve për punën e tyre, ose i sheh rezultatet e vlerësimit si jo-objektive.

C. Mundësitë

- Funkcionalizimi i mekanizmave ligjorë dhe institucionalë në ngritjen e cilësisë;

- Funkcionalizimi sa më optimal i hapësirës së Fakultetit për mbarëvajtjen e procesit mësimor, mbajtjen e provimeve, aktiviteteve të ndryshme ekstrakurrikulare, si konferenca etj.;
- Ngritja e cilësisë rritë gjasat e punësimit si brenda ashtu edhe jashtë Kosovës;
- Ngritja e cilësisë rritë mundësitë e pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare;
- Rritja e efikasitetit në zbatimin e rekomandimeve të ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit;
- Përditësimi i programit në riakreditim në përputhje me mësimet e mësuara (lessons learned) dhe praktikatat më të mira;
- Përmirësimi i procesit të vlerësimit të brendshëm të mësimdhënies dhe programit;
- Zbatimi i obligimeve nga korniza ligjore në fuqi për mekanizmat dhe aktivitetet për sigurimin e cilësisë dhe bashkëpunon ngushtë me akterët relevantë në këtë drejtim.

D. Sfidat

- Angazhimi i tepërt i stafit akademik në mësimdhënie dhe pune administrative e menaxhim;
- Angazhimi i stafit akademik në vende tjera të punës jashtë universitetit.
- Tregu i punës është mjaft i çakorduar dhe vazhdon të ketë probleme, të cilat i tejkalojnë ingerencat e Universitetit.
- Inkurajimi i studentëve të marrin pjesë në procedurat vlerësuese;
- Përmirësimi i vazhdueshëm dhe ngritja e kapaciteteve profesionale të stafit në pajtim me kërkesat e nevojat e departamentit, gjë që i tejkalon kompetencat e Departamentit por është çështje e planifikimeve buxhetore e strategjike të Universitetit e Fakultetit.

Treguesi i performancës 2.1. Mekanizmat e përshtatshëm të vlerësimit të programeve, duke përfshirë anketat e të diplomuarve, të dhënat e rezultateve të punësimit, reagimet e punëdhënësve dhe performancat pasuese të të diplomuarve përdoren për të siguruar dëshmi për përshtatshmërinë e rezultateve të synuara të mësimit dhe shkallën në të cilën ato janë arritur.

Universiteti i Prishtinës nuk ka mekanizma formal të matjes së nivelit të punësueshmërisë së të diplomuarve. Fakulteti nuk disponon me të dhëna zyrtare për profesionin e mëtutjeshëm të të diplomuarve. Nga informatat joformale që posedojnë anëtarët e Departamentit dhe nga lidhjet e tyre me Shoqatën e Filozofëve të Kosovës del se një numër i të diplomuarve punon në arsim duke dhënë mësim në lëndët *logjikë, filozofi, etikë, të drejta të njeriut e edukatë qytetare*, por ka edhe prej tyre që punojnë në administratë shtetërore, OJQ, gazetari etj., e disa kanë vazhduar studimet në drejtimet tjera, kurse disa kanë dalur jashtë vendit.

Treguesi i performancës 2.2. Raportet u ofrohen administratorëve të programeve për shpërndarjen e secilit kurs dhe këto përfshijnë detaje nëse nuk mund të trajtohet ndonjë përmbajtje e planifikuar dhe ndonjë vështirësi në përdorimin e strategjive të planifikuara. Rregullimet e duhura janë bërë në planet për mësimdhënie pas shqyrtimit të raporteve të kursit.

Departamenti në takimet e rregullta diskuton edhe për ecurinë e implementimit të programit. Në rast se evidentohen ngecje në realizim të ndonjë komponente programore, për të hartohet raport dhe pastaj administratorët e programit rekomandojnë zgjidhjet e përshtatshme për shmangien e ngecjes. Zgjidhja rëndom bëhet duke e rimodeluar atë komponentë programore, ose duke e zëvendësuar me një komponentë të re. Kjo realizohet në sajë të aprovimit edhe nga ana e Prodekanit për Mësim dhe Koordinatorit për Sigurimin e Cilësisë.

Treguesi i performancës 2.3. Një rivlerësim gjithëpërfshirës i programit zhvillohet të paktën një herë në pesë vjet. Politikat dhe procedurat për kryerjen e këtij rivlerësimi janë publikuar. Rishikimi i programit përfshin njerëz me përvojë nga industrinë dhe profesionet përkatëse, dhe fakultetin me përvojë nga institucionet e tjera.

Për programet e nivelit MA rivlerësimi është bërë në përputhje me kohëzgjatjen e vlefshmërisë së programit, e cila rëndom ka qenë 3 vite. Rivlerësimi i programit i përfshinë të gjitha hallkat institucionale të Universitetit (përfshirë Senatit, i cili përfshihet vetëm në rastet e programeve të reja) e deri te Agjencia e Akreditimit e Kosovës, e cila angazhon ekspertë ndërkombëtarë të fushave, për ta vlerësuar qëndrueshmërinë kurrikulare të programit. Po ashtu, më konkretisht, gjatë procesit vlerësues përfshihen pjesëtarë të stafit akademik me kualifikime dhe përvoja relevante nga fusha e programit përkatës, si dhe rekomandimet dhe ekspertizat nga studiues të universiteteve që Departamenti ka komunikime profesionale (deri tani ka qenë prof. Dr. David Weberman nga Universiteti i CEU Budapest).

Treguesi i performancës 2.4. Studentët marrin pjesë në hartimin dhe zbatimin e proceseve të sigurimit të cilësisë.

Studentët janë pjesë e drejtpërdrejtë dhe e jo drejtpërdrejtë e proceseve për sigurimin e cilësisë. Ata janë pjesë e komisioneve të Universitetit e Fakultetit, atyre për zhvillim dhe vlerësim të programeve studimore, me ç'rast ata ofrojnë përvojat e tyre dhe dokumentojnë dobësitë eventuale të programeve pararendëse. Po ashtu, duke qenë se ata janë vlerësues të drejtpërdrejtë të vlerësimit të performancës së profesorëve lidhur me realizimin e lëndëve të programit të caktuar përmes SEMS, ata kontribuojnë në gjetjen e indikatorëve të rëndësishëm përkitazi me dobësitë eventuale të programit, e të cilat synohet të evitohen në mënyrë periodike. Ky proces rregullohet përmes 'Udhëzuesit për vlerësimin e lëndëve nga studentët dhe përdorimin e tyre në Universitetin e Prishtinës, nr. 1/438, 2018.'

1.2. Stafi akademik

*Standardi 3.1. Kandidatët për punësim sigurohen me përshkrime të plota pozicioni dhe kushtet e punësimit. *Të prezantohen në formë tabelare të dhënat për stafin akademik/ artistic Full Time*

(FT) dhe Part Time (PT) që përfshijnë: emrin, kualifikimin, titullin akademik, kohëzgjatjen e kontratës (së vlefshme) zyrtare, ngarkesa për mësimdhënie, provimet, konsultimet, aktivitetet administrative, hulumtimet, etj. për programin e studimit nën vlerësim.

Stafi akademik i punësuar në Departamentin e Filozofisë, në kuadër të të cilave implementohet ky program, e realizon aktivitetin e tyre FT në përputhje të plotë me dispozitat statutare të UP-së. Për këtë program kemi këtë pasqyrë të angazhimit:

Personeli i Përhershëm				Kontrata në bazë të angazhimit - orë në javë			Kontrata mbi norme - orë në javë		Veprimt. Admin./Hulumt.
Nr	Emri mbiemri	Gr. Shk.	Thirrja akad.	Kohëzgj. kontratës	Sem. dimeror	Semestri	Sem dimeror/ Ligjerata	Sem. Veror ligjerata	
1	2	3	4						
1	Astrit Salihu	Dr.	Prof. Assoc. Dr.	30.09.2017 - dhe me vazhdim automatik njëvjeçar deri në zgjedhje rizgjedhje në konkursin e ardhshëm	2	4	0	0	Bartës i programit BA në Filozofi
2	Hasnije Ilazi	Dr.	Prof. Ass. Dr.	9.6.2021	3	2	0	0	Bartëse e programit MA në Filozofi
3	Kristë Shtufi	Dr.	Prof. Ass. Dr.	23.7.2022	5	5	0	0	Shef Departamenti
4	Blerim Latifi	Dr.	Prof. Ass. Dr.	1.6.2019	4	2	0	0	
5	Valon Leci	Dr.	Ass.	1.10.2023	6 Usht rime	0	0	0	Sekretar Departamenti
6	Anton Vukpalaj	Dr.	Prof. Ass. Dr.	12.3.2017 - dhe me vazhdim automatik njëvjeçar deri në	2	0	0	0	

				zgjedhje ose rizgjedhje në konkursin e ardhshëm					
7	Ardian Gola	Dr.	Ass.	5.7.2017 - dhe me vazhdim automatik njëvjeçar deri në rizgjedhje në konkursin e ardhshëm	2	0	0	0	Shef Departamenti i Sociologjisë
8	Kadri Metaj	Dr.	Prof. Dr. i pensionuar	I planifikuar për 5 vjet, por zgjedhet cdo vjet.	2	2	0	0	

Për çdo lëndë të cekur ekzistojnë ligjëratat dhe ushtrimet. Pë ligjërata angazhohet stafi i rregullt që ka thirrjen së paku Prof. Ass. Dr., kurse për ushtrime për momentin rekrutohet me konkurs publik vetëm staf i jashtëm akademik ose për disa lëndë përkatëse angazhohet stafi akademik nga departamentet tjera. Meqenëse nuk mund të paragjykohet zgjedhja e tyre, për momentin nuk mund të jepen emra konkret. Gjithsesi asistentat për ushtrime duhet të kenë së paku titullin MA dhe të kenë një CV adekuate profesionale për t'u angazhuar në mbajtjen e ushtrimeve. Asistentët s'mund të jenë bartës të lëndëve dhe nota përfundimtare studentit i vendoset nga bartësi i lëndës.

Standardi 3.2. Stafi mësimor duhet të jetë në përputhje me kërkesat ligjore lidhur me profesionin e pozitave mësimore të përfshira në Udhëzimin Administrativ për Akreditim.

Stafi akademik i angazhuar në këtë program është në përputhje me kërkesat ligjore lidhur me profesionin e pozitave mësimore të përfshira në Udhëzimin Administrativ për Akreditim.

Standardi 3.3. Stafi akademik nuk mbulon, brenda një viti akademik, më shumë se dy pozita mësimore (një me orar të plotë, një me kohë të pjesshme), pavarësisht nga institucioni arsimor ku ata kryejnë veprimtarinë e tyre.

I gjithë stafi akademik që është angazhuar në këtë program (për ligjërata) është me normë *full time* dhe vepron në përputhje me kërkesat ligjore. Stafi për disa ushtrime për momentin rekrutohet nga jashtë çdo vit.

Standardi 3.4. Të paktën 50% e stafit akademik në programin e studimit janë punonjës me kohë të plotë dhe përbëjnë të paktën 50% të klasave të programit të studimit.

I tërë stafi akademik që ofron ligjërata në këtë program, është me marrëdhënie të rregullt pune. Disa nga ushtrimet i mban stafi akademik i angazhuar nga jashtë.

Standardi 3.5. Për çdo grup studentësh (të përcaktuar me statutin e institucionit) dhe për çdo 60 kredi ECTS në programin e studimit, institucioni ka punësuar të paktën një punonjës me orar të plotë me titull doktore ose titull të njëjtë në rastin e institucioneve shkencore artistike/aplikative.

Departamenti i Filozofisë ka të siguar staf të mjaftueshëm me normë të plotë dhe me thirrje adekuate akademike në përputhje me dispozitat e statutit të UP-së dhe rregulloret në fuqi.

Standardi 3.6. Janë ofruar mundësi për zhvillim profesional shtesë të stafit mësimdhënës, me ndihmën e veçantë që u jepet çdo personi që has vështirësi.

Stafi akademik ka mundësi zhvillimi profesional duke marrë pjesë në konferenca brenda dhe jashtë vendit, inkurajohet që të botojë jashtë vendit nëpër revista të kategorizuara në SCOPUS e Web of Science si dhe ka mundësi për botime monografike në Shtëpinë Botuese të Universitetit të Prishtinës, edhe pse procedurat e botimit prolongohen tepër gjatë.

Standardi 3.7. Përgjegjësitë e të gjithë stafit mësimdhënës, sidomos me kohë të plotë, përfshijnë angazhimin në komunitetin akademik, disponueshmërinë për konsultime me studentët dhe shërbimin e komunitetit.

Stafi mësimdhënës ka angazhim në komunitetin akademik, ka kohën e caktuar të publikuar për konsultime me studentët (sipas kontratës) dhe është i angazhuar në shërbimin e komunitetit: (p.sh. Hasnije Ilazi anëtare e Komisionit Këshilldhënës për Avancimin e Stafit në kuadër të Rektoratit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, si dhe është kryetare e Shoqatës së Filozofëve të Kosovës, Kristë Shtufi është Shef Departamenti dhe anëtar i Këshillit të Fakultetit, Astrit Salihu e Blerim Latifi janë anëtarë të Këshillit të Fakultetit, Valon Leci është Sekretar Departamenti.)

Standardi 3.8. Vlerësimi i stafit akademik kryhet rregullisht së paku përmes vetëvlerësimit, vlerësimit të nxënësve, kolegëve dhe mbikëqyrësve dhe ndodh në baza formale të paktën një herë në vit. Rezultatet e vlerësimit bëhen publike.

Vlerësimi i stafit akademik kryhet rregullisht së paku përmes vetëvlerësimit, vlerësimit të studentëve, kolegëve (gjatë zgjedhjes dhe rizgjedhjes së thirrjeve akademike) dhe mbikëqyrësve (prodekanit për mësim). Rezultatet e vlerësimit bëhen publike. Profesorët vlerësohen edhe përmes studentëve (edhe pse me numër të vogël) ku pyetësorët plotësohen në mënyrë elektronike dhe menaxhohen nga SEMS në nivel të Rektoratit të UP-së. Ekziston edhe mekanizmi i kontrollit të

mësimdhënies përmes Zyrtarit për Mësim dhe Prodekanit për mësim dhe Koordinatorit për Zhvillim akademik.

Standardi 3.9. Strategjitë për përmirësimin e cilësisë përfshijnë përmirësimin e strategjive të mësimdhënies dhe cilësinë e materialeve mësimore.

Koordinatori për Zhvillim Akademik bashkë me Dekanatin e Fakultetit ndërmarrin hapa të nevojshëm për përmirësimin e strategjive të mësimdhënies dhe të materialeve mësimore përmes kërkesës për përmirësimin dhe risfreskimin e syllabuseve në përputhje me botimet më të reja në disiplinat e caktuara, duke theksuar këtu edhe në krijimin e kushteve më të mira teknologjike në përputhje me kërkesat e kohës.

Standardi 3.10. Mësimdhënësit pensionohen në kufijtë e moshës ose për arsye të tjera humbasin statusin e mësimdhënësve me orar të plotë dhe konsiderohen mësues me kohë të pjesshme.

Pensionimi i mësimdhënësve është i paraparë me dispozitat ligjore dhe me statutin e UP. Staf i rregullt akademik punon *full time* deri 65 vjet, kurse sipas nevojave të departamenteve një mësimdhënës i caktuar mund të angazhohet si staf *part time* deri 70 vjet.

Analiza SWOT për stafin akademik:

A. Pikat e forta

- I gjithë stafi është i angazhuar në ligjërata është me normë *full time* (FT);
- Përgatitja e stafit akademik është adekuate për lëndët që ligjëron;
- I gjithë stafi akademik *full time* i angazhuar në këtë program ka të përfunduara së paku studimet e doktoratës jashtë vendit: Astrit Salihu (doktorata e Zagrebit, Kroaci), Hasnije Ilazi (magjistratura dhe doktorata e Zagrebit, Kroaci), Kristë Shtufi (stë gjitha nivelet e studimeve në Asutri); Blerim Latifi (masteri dhe doktorata e Tiranës, Shqipëri), Valon Leci (doktorata e Tiranës, Shqipëri), Anton Vukpalaj (të gjitha nivelet e studimeve në Francë), Ardian Gola (doktorata e Tiranës, Shqipëri).
- Stafi është produktiv dhe ka një sërë botimesh shkencore në përputhje me thirrjet, dhe me kompetencë ligjërojnë lëndët, për të cilat janë bartës.
- Stafi është aktiv në organizimin dhe pjesëmarrjen e konferencave ndërkombëtare (Organizon çdo vit së paku një konference ndërkombëtare në Prishtinë).
- Stafi është aktiv në pjesëmarrjen e programeve dhe projekteve ndërkombëtare (ERASMUS+, CEEPUS, Universitete Verore).
- I gjithë stafi akademik i këtij programi njohuri së paku të gjuhëve angleze dhe asaj kroate, gjë që jep përparësi në përgatitjen për mësimdhënie dhe për zhvillim të mëtutjeshëm dhe për avancim profesional e pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare;

- I gjithë stafi i rregullt akademik ka një përvojë së paku dhjetëvjeçare në mësimdhënie, hulumtim e përkthime të ndryshme të teksteve filzofike;
- Disa nga mësimdhënësit, sidomos ata të filozofisë praktike, posedojnë karrierë të ndryshme politike e menaxheriale, e cila i jep programit një vlerë shtesë aplikative;

B. Dobësitë

- Edhe pse i tërë stafi i angazhuar posedon njohuri të anglishtes dhe kroatishtes, një numër i stafit nuk qëndron mirë me njohjen e gjuhëve specifike si gjermanisht, frëngjisht, ku dihet se shumë filozof të mëdhenj kanë shkruar në këto gjuhë.
- Departamenti i Filozofisë nuk ka autonomi në rekrutimin e stafit *Full Time* dhe *Part Time* në përputhje të plotë me nevojat e brendshme, sepse kjo është kompetencë e centralizuar në nivel të rektoratit, dhe duhet t'i përshtatet krejtësisht Strategjisë së Zhvillimit të Fakultetit Filozofik dhe Rektoratit.
- Nuk ka fonde të mjaftueshme për zhvillimin profesional të stafit akademik.

C. Mundësitë

- Sipas Strategjisë për Zhvillim të Fakultetit Filozofik, brenda viteve 2018-2023 Departamenti i Filozofisë do të angazhojë Tre (3) profesorë të zgjedhur (full time) dhe katër (4) asistentë (full time). Burimi shqip: [http://filozofiku.uni-pr.edu/getattachment/Ballina/1--STRATEGJIA-E-ZHVILLIMIT--E--FAKULTETIT-FILOZOFIK-2018-2023-\(Shqip\).pdf.aspx](http://filozofiku.uni-pr.edu/getattachment/Ballina/1--STRATEGJIA-E-ZHVILLIMIT--E--FAKULTETIT-FILOZOFIK-2018-2023-(Shqip).pdf.aspx). Burimi anglisht: [http://filozofiku.uni-pr.edu/getattachment/Ballina/1--STRATEGJIA-E-ZHVILLIMIT--E--FAKULTETIT-FILOZOFIK-2018-2023-\(Anglisht\).pdf.aspx](http://filozofiku.uni-pr.edu/getattachment/Ballina/1--STRATEGJIA-E-ZHVILLIMIT--E--FAKULTETIT-FILOZOFIK-2018-2023-(Anglisht).pdf.aspx).
- Zhvillimi i stafit akademik do të mundësohet përmes mbështetjes financiare në pjesëmarrjen më të madhe nëpër konferenca ndërkombëtare;

D. Sfidat

- Sfidë kryesore për zhvillimin e mëtejshëm kadrovik mbetet mungesa e fondeve dhe asistencës financiare, pa të cilën ata nuk mund të kenë shumë qasje në aktivitete kërkimore dhe trajnuese;
- Paqëndrueshmëria e akteve juridike që rregullojnë statutin dhe avancimin në karrierë të stafit akademik.
- Mungesa e lëvizjes së lirë në vendet e Bashkimit Evropian për mësimdhënësit me qëllim të pjesëmarrjes nëpër konferenca ndërkombëtare.
- Procedurat e stërzgjatura dhe hvetëm me financim vetanak për botime në Shtëpinë Botuese të Universitetit të Prishtinës.

- Konkursi jo i rregullt kohor nga ana e Universitetit të Prishtinës për anëtarë të ri të rregullt të stafit akademik.
- Furnizimi me literaturën më të re të fushave ku ligjëron stafi akademik.
- Pagesa e minimale për angazhimin në komunitetin akademik dhe në postet menaxheriale.
- Mospoentimi respektivisht mosvlerësimi për avancim i mësimdhënies dhe agazhimit shtesë administrative e menaxherial për komunitetin akademik.

Treguesi i performancës 3.1. Personeli mësimor inkurajohet të zhvillojë strategji për përmirësimin e mësimdhënies së vet dhe të mbajë shënimin e provave të vlerësimeve dhe strategjive për përmirësim.

Brenda Universitetit të Prishtinës ekziston Zyra për Përsosmëri në Mësimdhënie që kërkon nga mësimdhënësit që para çdo avancimi të trajnohet për metodologji të reja në mësimdhënie. Fakulteti Filozofik ka hartuar Strategjinë e Zhvillimit 2018-2023 ku parashihen fushat e ndërhyrjes me qëllim të avancimit të cilësisë. Sigurisht se edhe stafi është i lirë, e madje edhe inkurajohet, të jetë inovativ në sajimin e teknikave të reja të mësimdhënies, të cilat do të ndikojnë pozitivisht në ngritjen e cilësisë. Ata, madje, edhe individualisht kanë marrë edhe përvoja nga vizitat dhe bashkëpunimet me kolegët e tyre në universitete të ndryshme në rajon dhe më gjerë.

Treguesi i performancës 3.2. Programet e trajnimit në aftësitë e mësimdhënies ofrohen për stafin e ri dhe atë ekzistues, duke përfshirë edhe stafin e angazhuar me kohë të pjesshme; këto përfshijnë përdorimin efektiv të teknologjisë së re dhe në zhvillim.

Menaxhmenti i Universitetit të Prishtinës, me Zyrën për Përsosmëri në Mësimdhënie gjatë dy viteve të fundit ka organizuar disa trajnime për stafin akademik lidhur me avancimin e kapaciteteve të tyre për mësimdhënie. Këto trajnime janë obligative për të gjithë mësimdhënësit që synojnë avancimin e tyre në thirrje akademike.

Treguesi i performancës 3.3. Shtrirja në të cilën personeli mësimor është i përfshirë në zhvillimin profesional për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies është duke u monitoruar.

Dekanati i Fakultetit Filozofik njoftohet lidhur me trajnimet e personelit të vet, pasi që mësimdhënësit e njoftojnë menaxhmentin e fakultetit. Për trajnimet brenda vendit mësimdhënësit i paraqesin ato në CV-të e tyre që i kanë të publikuara e uebfaqen e Fakultetit. Poashtu personeli mësimor e informon menaxhmentin për pjesëmarrjen në trajnimet e organizuara nga Zyra për Përsosmëri në Mësimdhënie.

Treguesi i performancës 3.4. Rezultatet e vlerësimit të stafit akademik merren parasysh për qëllime promovimi dhe rinovim të kontratave.

Gjatë procesit të avancimit të stafit të vet akademik Universiteti i merr parasysh vlerësimet e stafit akademik si një prej kritereve të saj poentues të performancës. Për këtë qëllim Dekanati e informon edhe personelin për rezultate e vlerësimit nga ana e studentëve në baza vjetore me qëllim që ata ta ngrisin cilësinë e performancës, duke marrë parasysh se kjo merret si një prej kritereve të avancimit.

1.3. Përmbajtja e procesit arsimor

Standardi 4.1. Programi i studimit është modeluar në objektivat e kualifikimit. Këto përfshijnë aspekte të lidhura me lëndët dhe ndërdisiplinore si dhe përvetësimin e shkathtësive dhe kompetencave disiplinore, metodologjike dhe gjenerike. Aspektet i referohen sidomos kompetencave akademike ose artistike, aftësisë për të marrë punësim adekuat, duke kontribuar në shoqërinë civile dhe zhvillimin e personalitetit të studentëve.

Në programin MA në Filozofi në vlerësim është marrë parasysh interdisiplinariteti, sidomos nga fushat e shkencave sociale. Meqenëse në Kosovë nëpër disa lloje të shkollave si gjimnazet e përgjithshme dhe shkollat teknike mësohet *filozofia e logjika*, por edhe *etika, edukata qytetare dhe të drejtat e njeriut*, programi ka për qëllim që t'i aftësojë studentët që të mund të japin mësim në këto lëndë në shkolla të mesme, të punojnë OJQ, media, gazetari, administrate publike e shtetërore etj.

Standardi 4.2. Programi i studimit është në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe Kornizën për Kualifikimet e Zonës Europiane të Arsimit të Lartë. Komponentët individualë të programit kombinohen në një mënyrë që të arrijnë më së miri objektivat e specifikuar të kualifikimit dhe ofrojnë forma adekuate të mësimdhënies dhe të mësuarit.

Ky program studimi është zhvilluar në përputhje të plotë me standardet e Zonës së Arsimit të Lartë Evropian e cila karakterizohet me modelin e studimeve në tre cikla të studimit dhe ku studimet Master përbëjnë ciklin e dytë të studimeve me 120 ECTS. Përpilimi i programit me standarde të tilla u mundëson studentëve të lëvizin brenda hapsirës evropiane të studimit dhe të vazhdojnë studimet brenda dhe jashtë vendit.

Standardi 4.3. Disiplinat brenda kurrikulit sigurohen në një rrjedhë logjike dhe plotësojnë përkufizimin dhe përcaktimin e saktë të kompetencave të përgjithshme dhe specifike, si dhe pajtueshmërinë me programet e studimit dhe kurrikulat e dorëzuara në ZEAL. Duhet të listohen të paktën 7 rezultatet të të nxënësve për programin e studimit nën vlerësim.

Këto janë disa nga rezultatet e pritura të të nxënësve:

1. Studentët aftësohen të shkruajnë, të analizojnë dhe të mendojnë në mënyrë logjike e kritike dhe përkohësisht të marrin pjesë në projekte e në institucione të ndryshme.

2. Studentët zhvillojnë njohuri të thelluara nga logjika dhe filozofia teorike, me anë të cilave do të përmirësojnë kompetencat e argumentimit, të artikulimit dhe kompetencën racionale të kritikës dhe të ballafaqohen me pozicionet e ndryshme të orientimit në botë.
3. Studentët arrijnë njohuri më të thelluara nga historia e filozofisë, me anë të të cilave arrihet njëformim humanistik dhe aftësia për kuptimin, analizën dhe interpretimin e veprave filozofike dhe ballafaqimit me pikëpamjet dhe drejtimit filozofike.
4. Studentët arrijnë njohuri të avancuara dhe të thelluara të koncepteve dhe teorive nga filozofia praktike, me anë të të cilave mund të arrijnë një kompetencë të reflektimit për veten dhe të orientimit social-moral.
5. Studentët janë kompetent për zgjidhje problemore teorike dhe praktike.
6. Studentët janë kompetent që në bazë të metodave logjike dhe të analizës konceptuale të analizojnë tekste dhe kontekste me një saktësi argumentative dhe që t'i kritikojnë ato me instrumente shkencore dhe filozofike.
7. Studentët aftësohen që ta aplikojnë dijen në fushat profesionale dhe qëmbi këtë bazë të bashkëpunojnë edhe me grupe tjera bazuar në mendjehapësi dhe gjerësinë shtrimit të problemeve.
8. Studentët janë kompetent për gjykimin social-politik në bazë të metodave të analizës së botëkuptimeve të ndryshme dhe të kritikës së ideologjive dhe dogmave.

Standardi 4.4. Disiplinat brenda kurrikulës kanë syllabusë analitike të cilët përfshijnë të paktën: objektivat e disiplinës, përmbajtja themelore tematike, rezultatet e të nxënësve, shpërndarja e klasave, seminarët dhe aktivitetet aplikative, sistemi i vlerësimit të studentëve, bibliografia minimale, etj. Përshkrimet e plota të lëndëve/ syllabusët për secilën lëndë duhet të bashkëngjiten vetëm në formë elektronike raportit të vet vlerësimit për programin e studimit nën vlerësim.

Programi është hartuar në pajtim me standardet e kërkuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës dhe Agjencia Kosovare e Akreditimit, të cilat kanë përcaktuar standarde evropiane për programet e studimit.

Standardi 4.5. Nëse gjuha e mësimdhënies është e ndryshme nga ajo Shqipe, merren masa për të siguruar që aftësitë gjuhësore të të dy studentëve dhe stafit akademik janë adekuate për mësimin në atë gjuhë kur studentët fillojnë studimet e tyre. Kjo mund të bëhet përmes trajnimeve gjuhësore para fillimit të programit.

Programi zhvillohet në gjuhën shqipe. Kusht për regjistrimin e studentëve në këtë program është njohja e një gjuhe të caktuar të huaj nga ana e studentit. Stafi akademik njihet së paku gjuhën angleze dhe atë kroate.

Standardi 4.6. Marrëdhënia student-mësues është një partneritet në të cilin secili merr përgjegjësinë e arritjes së rezultateve të mësimin. Rezultatet e mësimin shpjegohet dhe diskutohen me studentët nga këndvështrimi i rëndësisë së tyre në zhvillimin e studentëve.

Stafi akademik është i orientuar kah arritja e rezultateve të studentit si epiqendër dhe qëllim final i zhvillimit të mësimi.

Standardi 4.7. Strategjitë e mësimdhënies janë të përshtatshme për llojet e ndryshme të programeve të rezultateve të të mësuarit që synojnë të zhvillohen. Strategjitë e mësimdhënies dhe vlerësimit të përcaktuara në specifikimet e programeve dhe kurseve janë ndjekur me fleksibilitet për të plotësuar nevojat e grupeve të ndryshme të studentëve.

Njohuritë që jepen në këtë program marrin parasysh aftësitë e ndryshme të studentëve. Studentët janë të obliguar që në konkurs të kalojnë prapën e kalueshmërisë së testit pranues, gjë që bën që në program të pranohen vetëm studentët me njohuri dhe kapacitetet të mjaftueshme për të absorbuar njohuritë e avancuara të kurseve që ofrohen në këtë program. Vlerësimi i studentëve njihet nga 5-10 dhe kështu parasheh larmi në vlerësim. Syllabuset e kurseve janë të përpiluara në përputhje me nivelin master të studimeve, por duke marrë parasysh diversitetin e aftësive të studentëve që kalojnë prapën e kalueshmërisë për regjistrim në këtë program dhe diversitetin e fushave të studentëve që regjistrohen në këtë program.

Standardi 4.8. Mekanizmat e vlerësimit të nxënësve zhvillohen në mënyrë të drejtë dhe objektive, janë të përshtatshme për format e ndryshme të të mësuarit të kërkuar dhe u komunikohen qartë studentëve në fillim të kurseve.

Syllabuset e kurseve të ofruara në program saktësojnë në mënyrë koncize kushtet e kalueshmërisë dhe vlerësimit. Profesorët mbajnë në pjesën më të madhe provime me shkrim dhe disa ofrojnë edhe kollokvijume dhe provime edhe me gojë, në përputhje me statutin e Universitetit të Prishtinës dhe vlerësojnë në mënyrë të drejtë dhe objektive. Këto mekanizma u jepen studentëve në fillim të semestrit dhe u sqarohen atyre në mënyrë shprehimore, por shpallen edhe në uebfaqen e Departamentit, por mund të vendosen edhe në mënyrë elektronike në programin SEMS për notimin e studentëve ku studentët mund të kenë qasje pa limit në këto syllabuse e metoda të vlerësimit. Ekziston edhe mekanizmi i ankesës eventuale për notat, të cilën Fakulteti e trajton me afate të parapara me Statut.

Standardi 4.9. Mekanizmat e përshtatshëm, të vlefshëm dhe të besueshëm përdoren për të verifikuar standardet e arritjeve të nxënësve. Standardi i punës i kërkuar për nota të ndryshme është konsistent me kalimin e kohës, i krahasueshëm në kurset e ofruara brenda një programi dhe në krahasim me programet e tjera të studimit në institucionet e vlerësuara.

Mekanizmat e vlerësimit të arritshmërisë janë të vendosura nëpër syllabuse. Vlerësimi ka një standard të qëndrueshëm që është i krahasueshëm me vlerësimin në lëndët brenda programit dhe me programet tjera në Fakultetin Filozofik dhe në Universitetin e Prishtinës.

Standardi 4.10. Politikat dhe procedurat përfshijnë veprimet që duhen ndërmarrë për të trajtuar situatat ku standardet e arritjeve të nxënësve janë të pamjaftueshme ose vlerësohen në mënyrë jokonsistente.

Ekzistojnë oraret e konsultimevetë shpallura, ku studentët mund të diskutojnë me profesorët për paqartësitë rreth performancës dhe rezultateve të tyre. Në bazë të Statutit të Universitetit të Prishtinës ekziston edhe mekanizmi i ankimimit për notat, ku në bazë të ankesës së studentit, *Fakulteti* bashkë me *Komisionin për ankesa* ngrit një komision për vlerësimin e studentit në kohë të paraparë me statut të Universitetit të Prishtinës.

Standardi 4.11. Nëse programi i studimit përfshin faza praktike, rezultatet e pritshme të mësimit së nxënësve janë të specifikuara qartë dhe proceset efektive ndiqen për të siguruar që rezultatet e mësimit dhe strategjitë për të zhvilluar atë mësimit janë kuptuar nga studentët. Fazat e praktikës janë ndarë kredi ECTS dhe puna e studentëve në organizatat e trajnimit praktik monitorohet përmes raporteve të aktiviteteve; studentët gjatë fazave të praktikës kanë caktuar mësues nga personeli akademik në programin e studimit.

Ky program nuk parasheh ndonjë fazë praktike.

Standardi 4.12. Për të lehtësuar fazat e praktikës, institucioni i arsimit të lartë nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi, kontrata ose dokumente të tjera me institucionet/organizatat/njësitë e trajnimit praktik.

Ky program nuk parasheh ndonjë fazë praktike.

SWOT analiza për përmbajtjen e procesit mësimor

A. Pikat e forta:

- Ky program është dizajnuar në përputhje të plotë me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe Kornizën për Kualifikimet e Zonës Europiane të Arsimit të Lartë.
- Duke marrë parasysh edhe interdisiplinaritetin e tij, studentët që përfundojnë këtë program aftësohen për të dhënë mësimit nëpër shkolla ku ka filozofi, logjikë, etikë, por edhe të drejta të njeriut e edukatë qytetare.
- Programi ofron lëndë që zhvillojnë mendimin kritik dhe qasjen analitike ndaj problemeve, pikëpamjeve, pozicioneve, teorive, koncepteve dhe teksteve filozofike.
- Lëndët trajtojnë tema filozofike si të përgjithshme poashtu edhe specifike që debatohen aktualisht, duke marrë për bazë literaturën më të re ose më relevante të disiplinave të trajtuara me metodologji të avansuara të mësimdhënies.
- Programi ka kursin e shkrimit akademik në filozofi që i aftëson studentët që idetë e tyre filozofike t'i elaborojnë dhe t'i paraqesin në mënyrë të shkruar dhe eventualisht t'i botojnë në revista brenda e jashtë vendit.
- Ky program mbështetet në mësimdhënien e bazuar mbi hulumtimet e stafit që bart kurset përkatëse.

- Programi në kurset e veta parasheh jo vetëm paraqitjen e teorive të caktuara tematike, por edhe debatimin analitik e kritik dhe argumentimin pro e kundër teorive të paraqitura.
- Programi ka përfshirë lëndë, përmbajtja e së cilave u jep njohuritë adekuate studentëve për logjikë, histori të filozofisë, filozofi praktike e teorike si dhe për metoda të shkencave sociale e të drejtave të njeriut që i aftëson për hulumtim dhe punësim nëpër shkolla ku jepet logjika, filozofia, edukata qytetare e të drejtat e njeriut si lëndë zgjedhore nëpër shkolla.
- Ky program është atraktiv për të lidhur bashkëpunime me universitete ndërkombëtare për të shkëmbyer stafin akademik dhe studentë.

B. Dobësitë

- Pamjaftueshmëria e fondeve dhe e rrugëve të sigurta dhe të shpejta për sigurimin e literaturës së përditësuar për secilën lëndë: Universiteti nuk ka fonde të mjaftueshme për përditësimin e literaturës dhe profesorët janë të detyruar ta sigurojnë atë vetë, kurse Amazon.com nuk dërgon libra në Kosovë.
- Mungesa e njohjes së gjuhëve të huaja nga ana e studentëve për përcjelljen e pavarur të mësimdhënies është një dobësi, edhe pse stafi i paraqet njësitë mësimore konform literaturës ku bazohen kurset.
- Fonde të pamjaftueshme për qëndrimin e secilit student për së paku një semestër jashtë vendit, së paku dhe në rastin ideal për punimin e temës së masterit, edhe pse praktika ka treguar se disa studentë të dalluar aty këtu udhëtojnë jashtë vendit për qëndrime njëmuajore ose njësemestrale brenda Erasmus+, CEEPUS, ose ndonjë programi tjetër të Bashkimit Evropian.
- Qëndrimi i profesorëve jashtë vendit për të krijuar syllabuse ose kurrikula të reja.
- Mungesë e organizimit të provimeve nga një zyrë e veçantë e provimeve masive ku do të organizoheshin provimet pavarësisht nga profesori, ashtu sikurse është tashmë praktikë në perëndim.
- Mungesë e doktoraturës në filozofi në Universitetin e Prishtinës.

C. Mundësitë

- Përfundimi i këtij programi krijon mundësi për studentët për studime të mëtutjeshme doktorale.
- Universiteti mund të shpallë konkurs në afate më të shpeshta kohore për zgjerimin e departamentit me kuadro.

D. Sfidat

- Literatura në gjuhën shqipe, edhe pse punohet vazhdimisht në përkthimin e literaturës filozofike bazë.
- Sigurimi i fondeve për përkthimin e literaturës kyçe në gjuhën shqipe, edhe pse nga studentët kërkohet të njohin gjuhë të huaja për të studiuar në këtë program.

- Sigurimi i mundësive të bashkëpunimit shkak i prolongimit të vizave për qëndrime jashtë vendit.
- Qëndrimi i studentëve jashtë vendit për një e më shumë muaj gjatë studimeve.
- Mësimi i ngjuhës angleze e gjuhëve tjera për të përcjellur literaturën ku bazohet përmbajtja e lëndëve.
- Përshtatja e studentëve që vijnë nga drejtimet tjera me terminologjinë, problemet, pikëpamjet, qasjet, metodat dhe teoritë bazore të filozofisë për shkak se nuk kanë kryer studimet BA në filozofi.
- Krijimi i ndonjë Zyre të veçantë të provimeve nga ana e Universitetit ku do të organizoheshin provimet pavarësisht nga profesori përkatës, ashtu sikurse është tashmë praktikë në perëndim.
- Me qëllim që cilësia e mësimdhënies të jetë në nivelin më të lartë, universiteti duhet të krijojë mundësi të sigurimit të literaturës bashkëkohore dhe të përditësuar.
- Universiteti të krijojë qasje në platforma relevante për filozofi, JSTOR etj.

Treguesi i performancës 4.1. Fizibiliteti akademik i programit të studimit sigurohet duke marrë parasysh kualifikimet e pritura të hyrjes, një dizajn të përshtatshëm të kurrikulës, ngarkesën e punës të studentit që është kontrolluar për besueshmërinë, si dhe një numër të mjaftueshëm të ekzaminimeve.

Fizibiliteti akademik është i siguruar duke marrë parasysh misionin e Universitetit të Prishtinës, Strategjinë për Zhvillimin e Fakultetit Filozofik, përgatitjen e profesoratit, dizajnin e kurrikulës të krahasueshme me universitete me renome në Evropë, burimet njerëzore profesionale, arsyeshmërinë e ngarkesës së studentit si dhe numrin e mjaftueshëm të provimeve gjatë vitit akademik (3 afate obligative dhe 2 të jashtëzakonshme). Përveç kësaj një numër i profesorëve organizojnë edhe kollokvijume për vlerësimin e rezultateve të mësimin.

Treguesi i performancës 4.2. Mësuesit përdorin burime të reja të IT (e-mail, faqe personale, tema, bibliografi dhe burime të tjera në format elektronik dhe komunikim me studentët) dhe materiale ndihmëse, të tilla si tabela, tabela të vogëla lëvizëse dhe video-projektor.

Profesorët përdorin email, uebfaqen e fakultetit, por kanë mundësinë që materialet e mësimin t'i vendosin në SEMS për komunikim me studentët, përdorin tabela klasike me marker, dhe videoprojektorët për refletimin e sllajdeve të ndryshme me PPT ose me pdf.

Treguesi i performancës 4.3. Efektshmëria e strategjive të planifikuara të mësimdhënies në arritjen e llojeve të ndryshme të rezultateve të mësimin vlerësohet rregullisht dhe përshtatjet bëhen në përgjigje të provave për efektivitetin e tyre.

Mësimdhënia dhe mësimnxënia janë kompatible dhe efektshmëria e mësimdhënies në rezultatet e mësimnxënies vlerësohet rregullisht përmes provimeve dhe eventualisht ndryshohen ose përshtaten ato varësisht nga efektiviteti i tyre.

Informatat për programin e studimit.

Semestri: I						
Nr.	O/Z	Lënda	Ligjërata	Ushtrime	ECTS	Mësimdhënësi
1	O	Logjikë	3	2	8	Prof. Ass. Dr. Kristë Shtufi
2	O	Konceptet filozofike të Platonit dhe Aristotelit	2	2	7	Prof. Asoc. Dr. Astrit Salihu
3	O	Filozofi e shkencës dhe metodologji	2	2	5	Prof. Dr. Kadri Metaj
4	O	Politika, religjioni dhe kultura	2	2	5	Prof. Ass. Dr. Blerim Latifi Ass. Dr. Valon Leci (ushtrimet)
5	O	Shkrim akademik në filozofi	2	2	5	Prof. Ass. Dr. Kristë Shtufi
Totali			11	10	30	
Semestri: II						
Nr.	O/Z					
1	O	Problemet kryesore të filozofisë moderne	3	2	8	Prof. Ass. Dr. Hasnije Ilazi
2	O	Teori e njohjes	3	2	7	Prof. Ass. Dr. Kristë Shtufi
3	O	Hermeneutika filozofike	2	2	5	Prof. Ass. Dr. Blerim Latifi
4	O	Arti dhe shoqëria	2	2	5	Prof. Dr. Kadri Metaj
5/a	Z	Filozofi e gjuhës	2	2	5	Prof. Ass. Dr. Kristë Shtufi
5/b	Z	Frege	2	2	5	Prof. Ass. Dr. Kristë Shtufi
Totali			12	10	30	

Semestri: III						
Nr.	O/Z	Lënda	Ligjerata	Ushtrime	ECTS	Mësimdhënësi

1	O	Filozofi e moralit	2	2	7	Prof. Ass. Dr. Blerim Latifi Ass. Dr. Valon Leci (ushtrimet)
3	O	Filozofi sociale	2	2	7	Prof. Ass. Dr. Hasnije Ilazi
3	O	Autorët e përzgjedhur nga filozofia bashkëkohore	2	2	6	Prof. Asoc. Dr. Astrit Salihu
4/a	Z	Teoritë kritike bashkëkohore	2	2	5	Ass. Dr. Ardian Gola
4/b	Z	Filozofi e të drejtave të njeriut	2	2	5	Prof. Ass. Dr. Anton Vukpalaj Ass. Dr. Valon Leci (ushtrimet)
5/a	Z	Filozofi e arkitekturës	2	2	5	Prof. Asoc. Dr. Astrit Salihu
5/b	Z	Filozofi e mediave	2	2	5	Prof. Asoc. Dr. Astrit Salihu
Totali			10	10	30	
Semestri: IV						
Nr.	O/Z	Lënda	Ligjerata	Ushtrime	ECTS	
1	O	Punim diplome			30	
Totali					120	

1.

Emërtimi: Logjikë

Viti / semestri	Statusi	Ligjërata	Ushtrime	ECTS
I/I	Obligative	3	2	8

Objektivat dhe përmbajtja:

Në *ligjërata* do të jepen njohuri për nocionet dhe metodat themelore të logjikës – logjika propozicionale dhe ajo e predikateve me identitet dhe bashkësitë. Po ashtu rëndësi e veçantë do t’u kushtohet problemeve të logjikës filozofike me fokus te vetitë logjike, siç janë identiteti dhe teoria e përshkrimeve e të Rasëllit, ekzistenca, predikacioni, domosdoshmëria dhe e vërteta. Do të jepen bazat e logjikës modale. *Ushtrimet* janë aplikative dhe shërbejnë për t’i përforcuar me detyra shtëpie e punime seminarike njohuritë e fituara në ligjërata.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura (5-7) të mësimit:

Lënda ka për qëllim t’i aftësojë studentat për të ndërtuar një sistem të logjikës si dhe të ballafaqohen me problemet kryesore të vetive logjike.

Në përfundim të kursit studentët do të mësojnë 1. sistemin e logjikës së pohimeve (me sistemin e deduksionit natyror), 2. të predikateve me identitet dhe 3. problemeve kryesore të vetive logjike dhe që lidhen me teorinë e përshkrimeve të Russell, 4. bazat e logjikës modale.

Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies:

Mësimdhënja mbështetet në metodën e ligjërimit të mësimdhënsit mbi bazën e hulumtimeve, diskutimit dhe analizës së problemeve në seminare (ushtrime), përgatitjes së punimeve me shkrim nga ana e studentve, interpretimi i teksteve të kësaj fushe, dhe format tjera përkatëse për studimin e filozofisë.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:

Vlerësimi në këtë kurs është dizajnuar në atë mënyrë që tu ofrojë studentëve vazhdimisht informata se si janë duke përparuar dhe se ku duhet përforcuar konceptet.

Nota finale do të përllogaritet si më poshtë :

Përgatitjet për pjesëmarrje në klasë 20%

Detyrat me shkrim 20%

Provimi final me shkrim 60%

TOTAL 100%

Shpërndarja e fondit të orëve në raport me ECTS:

1 ECTS=25 orë; 8 ECTS= 200 orë ngarkese e studentit

45orë ligjërata; 30 orë ushtrime; 125 orë konsultime, detyra shtëpie; mësim individual; përgatitje për provim.

Mjetet e konkretizimit/ TI:

Për arritjen e rezultateve sa më të larta nga studentët, për realizimin e kursit, përveç librave dhe teksteve të nevojshme për ngritjen e cilësisë në shkrimin akademik do të përdoret edhe TI.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike te studimit:

Kursi do të kete 3 orë ligjerata dhe 2 orë ushtrime në javë. Njohuritë e ofruara gjatë ligjëratave do të diskutohen dhe sqarohen gjatë orëve të ushtrimeve, ku studentët do të kenë mundësi të verifikimit të njohurive të përvetësuara. Po ashtu, studentët do të realizojnë punën praktike përmes detyrave që do t'i kryejnë jashtë klasës (studimi i literatures në shtëpi, hulumtimi përmes TI etj.)

Do të stimulohet mësimi dhe avansimi i njohjes së gjuhës huaj.

Literatura shfrytëzohet në lëndë:

1. Halbach, V. (2010). *The Logic Manual*. Oxford: OUP.
2. Magnus, P. D., Tim Button (et al.) (2019). *Forall x: An Introduction to formal Logic*.
Online: <http://forallx.openlogicproject.org/forallxyyc.pdf>
3. McGinn, C. (2000). *Logical Properties: Identity, Existence, Predication, Necessity, Truth*. Oxford: Clarendon.
4. Jeffery, R., (2006). *Formal Logic: Its Scope and Limits*. Indianapolis: Hackett Publishing.
5. Priest, G. (2008). *An Introduction to Non-Classical Logic: From If to Is*. Cambridge: CUP

2. Emërtimi: Konceptet filozofike të Platonit dhe Aristotelit

Viti / semestri	Statusi	Ligjërata	Ushtrime	ECTS
I/I	Obligative	2	2	7

Objektivat dhe përmbajtja:

Filozofia e Platonit dhe Aristotelit paraqesin pikëpamjet më të rëndësishme në Historinë e Filozofisë Perëndimore. Ndikimi i këtyre dy mendimtarëve ka determinuar rrjedhat e filozofisë në të gjitha periudhat e Historisë së Filozofisë Perëndimore përfshirë edhe filozofinë e religjioneve. Ndikimi i këtyre mendimtarëve vazhdon edhe sot. Kursi mëton që të zhvilloj një elaborim të thelluar të ideve dhe koncepteve bazike të dy filozofëve, me anë të të cilave janë ndërtuar pikëpamjet e tyre. Trashëgimia e mendimeve të Platonit dhe Aristotelit paraqet një bazament relevant për të kuptuarit e rrjedhës së mendimit filozofik në përgjithësi në traditën e filozofisë perëndimore. Së këndejmi ata janë të paevitueshëm edhe për studimin e thelluar të zhvillimeve të fundit në debatet e mëdha të taboreve filozofike të njohura si filozofia analitike dhe e gjuhës (ose anglosaksone) dhe ajo kontinentale; qoftë duke u fokusuar në debatin mbi esencializmin si trashëgimi e drejtpërdrejtë platoniane, qoftë në studimin e problemeve të fizikës (me ndikimin deri tek fizika Newtoniane), logjikës (me formulimin e logjikes formale) dhe metafizikes si mënyrë e të menduarit për shumë shekuj e traditës filozofike si trashëgimi aristoteliane. Filozofia e këtyre dy mendimtarëve ka determinuar po ashtu edhe rrjedhat dhe rrymat e mendimit etik dhe politik në civilizimin perëndimorë.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura (5-7) të mësimt:

Që studentët të identifikojnë konceptet themelore të filozofisë së Platonit dhe Aristotelit
- që studentët të arrijnë njohje të thelluar të koncepteve themelore të Platonit dhe Aristotelit
- që studentët të arrijnë që të përkufizojnë qartë vijat e zhvillimit të mendimit filozofik të themeluara mbi nocionet burimore të këtyre mendimtarëve.
Studentët të aftësohen në analizën e rrjedhave në filozofi bazuar në konceptet themelore të Platonit dhe Aristotelit

Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies:

Ligjërata e avancuar dhe diskutime

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:

Metodat e vlerësimit:

Pjesëmarrja në mësim	10%
Angazhimet në ushtrime	15%
Provimi me test	30%
Provimi me gojë	45%

Shpërndarja e fondit të orëve në raport me ECTS:

1 ECTS=25; 7 ECTS= 175 orë.

30 orë ligjëriata; 30 ushtrime; 115 orë: konsultime, seminare, prezantime dhe mësim individual për kollokvijume dhe provimin final.

Mjetet e konkretizimit/ TI:

Do të mbështetet në ligjerata, diskutime dhe analizat e problemeve në ushtrime, përgaditjen e prezantimeve nga ana e studentve, interpretimin e teksteve filozofike dhe përgatitjen për provim me test dhe me gojë.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike te studimit:

Lënda do të kombinojë teorinë (ligjërata) dhe praktikën (ushtrime) gjatë takimeve me studentë me qëllim të trajtimit të koncepteve dhe qasjeve themelore që kanë të bëjnë me këtë kurs. Pjesa teorike do të fokusohet në teoritë kryesore, kurse pjesa praktike do të realizohet nëpërmjet punës seminarike dhe në formë interaktive.

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

1. Studies in Greek philosophy, Volume II "Socrates, Plato, and Their Tradition", Edited by, Daniel W. Graham, Princeton University Press 1996
2. W.K. Guthrie, A History of Greek Philosophy, I-IV, Cambridge University Press 1997
3. Jonathan Barnes, "Aristotle" (Past Masters), botoi Oxford University Press 1982.

3.

Emërtimi: Filozofi e shkencës dhe metodologji

Viti / semestri	Statusi	Ligjërata	Ushtrime	ECTS
I/I	Obligative	2	2	5

Objektivat dhe përmbajtja:

Filozofi e shkencës me Metodologji të hulumtimit shkencor do të ketë si piknisje rëndësinë epistemologjike dhe udhëzime praktike për hulumtimin; njohuritë dhe shkathtësitë dhe do të shkoqitet në pesë pjesë: 1. Grupi I problemeve që kanë të bëjnë me të menduarit për hulumtimin (çështje hulumtimi?; dijet, teoritë, paradigmat...2. Përgatitja e hulumtimit (planifikimi, literature, modelet, zgjedhja e metodave, zgjedhja e kampionit...3. Mbledhja e të dhënave (Pyetësorët, intervistat, grupet e fokusit, dokumentet, burimet KPK apo mbledhja përmes kompjuterit...4. Analiza e të dhënave (statistikore, tematike, analiza e rrëfimeve...5. Paraqitja e të dhënave dhe raporti...

Qëllimet dhe rezultatet e pritura (5-7) të mësimit:

Lënda ka për qëllim që të vetëdijësojë dhe aftësojë studentët të kuptojnë dhe zbatojnë metodat e hulumtimit teorikisht dhe praktikisht, në mënyrë që të aftësohen të adresojnë shkencorisht problemet e njeriut dhe shoqërisë...

Pas përfundimit të kursit studentët duhet të kuptojnë dhe zbatojnë aspekte epistemologjike dhe praktike të hulumtimit të literaturës dhe në terren.

Format e mësimit dhe mësuesit:

Ligjerata përmes prezantimit vizual (PP) shembuj dhe diskutime me studentë, si dhe prezantime projektesh hulumtuese.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:

Lënda do të përmbajë 100 pikë qe nënkupton suksesin e shkëlqëshëm dhe ato pike duhet fituar 50% gjatë semestrit, me pjesmarrje active dhe kryerje detyrash, kurse 50% tjetër do të fitohet në provimin përfundimtar me shkrim dhe me gojë;
91-100% shkëlqyeshëm; 81-90 %sh. Mire; 71-80% mire
61-70% kënaqëshem; 51-60% mjafton, plotësohen kriteret minimale...

Shpërndarja e fondit të orëve në raport me ECTS:

1 ECTS=25; 5 ECTS = 125 orë.

30 orë ligjërata; 30 ushtrime; 65 orë: konsultime, seminare, prezantime dhe mësim individual për provimin final.

Mjetet e konkretizimit/ TI:

Ligjërata; diskutime ne klasë; Prezantime seminarike.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike te studimit:

Lënda do të kombinojë teorinë dhe praktikën gjatë secilit takimeve me studentë me qëllim të trajtimit të koncepteve dhe qasjeve themelore që kanë të bëjnë me këtë kurs. Pjesa teorike do të fokusohet në teoritë kryesore, kurse pjesa praktike do të realizohet nëpërmjet punës seminarike dhe në formë interaktive.

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

- 1.Bob Mathews dhe Liz Ross: Metodatat e hulumtimit, udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane CDE, Tiranë-2011
- 2.Ranjit Kumar: Metodologjia e hulumtimit, CIEDRESEARCH 2014
3. Ian Hacking : The social Construction of What
Richard Rorty books, (Ne gj. Shqipe- Filozofia dhe e ardhmja...)

4.

Emërtimi: Politika, religjioni dhe kultura

Viti / semestri	Statusi	Ligjërata	Ushtrime	ECTS
I/I	Obligative	2	2	5

Objektivat dhe përmbajtja:

Kursi Politika, religjioni dhe kultura trajton raportet komplekse në mes këtyre tri sfera themelore të jetës sociale. Fokusi i këtij trajtimi është në kontekstin e shoqërisë moderne dhe bashkëkohore. Gjatë kursit do të elaborohen paradigmat e ndryshme në baza të të cilave moderniteti dhe shoqëria bashkëkohore përpiqen ta modelojnë raportin në mes këtyre tri sferave. Ky raport, sikurse dihet, është në epiqendër të debatit filozofik mbi modernitetin, sekularizimin e shoqërisë dhe zëvendësimin e religjionit me ideologjitë politike moderne, të cilat marrin përsipër shpresat dhe idetë e tij. Kursi gjithashtu trajton krizën e iluminizmit, e cila pasohet me idetë mbi shoqërinë postsekulare dhe rikthimin e identiteteve religjioze si faktorë në influencimin e proceseve dhe fenomeneve politike të botës bashkëkohore. Në këtë kontekst, kursi do të elaborojë dukuritë e fundamentalizmave të rinj religjioz dhe konceptet e multikulturalizmit e globalizimit.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura (5-7) të mësimit:

Studentët nga ky kurs duhet të fitojnë njohuri të thelluar mbi raportet komplekse në mes politikës, religjionit dhe kulturës në botën moderne dhe bashkëkohore.

Poashtu ata duhet të fitojnë njohuri mbi paradigmat themelore të këtyre raporteve dhe qasjet teorike mbi to.

Në përfundim të kursit studentet duhet

1. të jenë në gjëndje të artikulojnë qartë problemet e raportit në mes politikës, religjionit dhe kulturës
2. të jenë në gjëndje të analizojnë dhe shkruajnë në mënyrë të pavarur për këto probleme
3. të jenë në gjëndje të marrin aktivisht pjesë në debatet publike ku trajtohen këto probleme.

Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies:

Ligjërata, analizë të koncepteve, lexim të teksteve, punime seminarike dhe kolokiume.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:

Kolokium dhe provim final.

Shpërndarja e fondit të orëve në raport me ECTS:

1 ECTS=25; 5 ECTS = 125 orë.

30 orë ligjërata; 30 ushtrime; 65 orë: konsultime, seminare, prezantime dhe mësim individual për kolokvijume dhe provimin final.

Mjetet e konkretizimit/ TI:

Ligjërata; diskutime ne klasë; Prezantime seminarike.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike te studimit:

Lënda do të kombinojë teorinë (ligjërata) dhe praktikën (ushtrime) gjatë takimeve me studentë me qëllim të trajtimit të koncepteve dhe qasjeve themelore që kanë të bëjnë me këtë kurs. Pjesa teorike do të fokusohet në teorinë kryesore, kurse pjesa praktike do të realizohet nëpërmjet punës seminarike dhe në formë interaktive.

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

1. Marcela Cristi, From Civil to Political Religion: The Intersection of Culture, Religion and Politics, 2001.
2. Emilio Gentile, Fetë e Politikës, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 20017

5.

Emërtimi: Shkrim akademik në filozofi

Viti / semestri	Statusi	Ligjërata	Ushtrime	ECTS
I/I	Obligative	2	2	5

Objektivat dhe përmbajtja:

Kjo lëndë ka rol përgatitor për punën e suksesshme të studentëve në të shkruarit të punimeve seminarike (si pjesë obligative të kurikullimit), punimit të diplomës (master) dhe punimit shkencor-filozofik në përgjithësi. Në veçanti lënda do të përqendrohet në përgatitjen e artikujve shkencor (ese) si një nga forma më të përdorura aktualisht në shkrimin filozofik.

Lëndën do të përbëjnë këto pjesë tematike: përzgjedhja e temës (titullit) të punimit dhe literaturës; leximi i literaturës dhe koncipimi i punimit; shtrimi i problemit dhe paraqitja e tezës së përgjithshme; struktura e punimit akademik; strategjia e argumentimit; rileximi; revidimi, lektorimi dhe formatimi i tekstit; kategorizimi dhe publikimi i punimit shkencor-filozofik.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura (5-7) të mësimit:

Qëllimi i kursit është aftësimi i studentëve për të dalluar një punimin akademik nga punime jo akademike dhe aftësimi i tyre për artikullimin e substances shkencore dhe filozofike në formë të shkruar.

Studentët do të jenë të përgatitur për tu qasur teksteve filozofike në mënyrë përmbajtësore, analitike dhe kritike si dhe të shkruajnë tekste në mënyrë të argumentuar duke i përdorur metodat shkencore, akademike.

Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies:

Metodologjia e kursit është bazuar kryesisht në punë praktike duke i përfshirë edhe udhëzime bazike teorike. Përveç ligjeratave kursi do të përfshijë edhe detyra brenda dhe jashtë klase me të cilat do të përforcohen njësitet e veçanta programore, tërësitë tematike dhe puna individuale e studentëve.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:

Vlerësimi në këtë kurs është dizajnuar në atë mënyrë që tu ofrojë studentëve vazhdimisht informata se si janë duke përparuar dhe se ku duhet përforcuar konceptet. Nota finale do të përlogaritet si më poshtë :

Përgatitjet për pjesëmarrje në klasë 30%

Detyrat me shkrim 30%

Provimi final me shkrim 30%

Pjesëmarrja dhe aktiviteti në klasë 10%

TOTAL 100%

Shpërndarja e fondit të orëve në raport me ECTS:

1 ECTS=25; 5 ECTS = 125 orë.

30 orë ligjëriata; 30 ushtrime; 65 orë: konsultime, seminare, prezantime dhe mësim individual për provimin final.

Mjetet e konkretizimit/ TI:

Për arritjen e rezultateve sa më të larta nga studentët, për realizimin e kursit, përveç librave dhe teksteve të nevojshme për ngritjen e cilësisë në shkrimin akademik do të përdoret edhe TI.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Kursi do të ketë 2 orë ligjerata dhe 2 orë ushtrime në javë. Njohuritë e ofruara gjatë ligjeratave edhe përmes shembujve të shumtë do të konkretizohen gjatë orëve të ushtrimeve ku studentët do

të aplikojnë njohuritë e përvetësuar. Poashtu, studentët do të realizojnë punën praktike përmes detyrave që do t'i kryejnë jashtë klasës (detyrat e shtëpisë, punimet seminarike hulumtimi përmes TI etj.)

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

1. Martinich, A.P. (2016). *Philosophical writing: An introduction*. Oxford: Blackwell Publishing.
2. Pryor, J. (s. d.). Guidelines on Writing a Philosophy Paper. In: <http://www.jimpryor.net/teaching/guidelines/writing.html>
3. Benn, C., Cameron, Ch., Cawston, A., and Siriwardena, Sh. (2013). *Tackling the Philosophy Essay: A Student Guide*. Online: <https://www.phil.cam.ac.uk/curr-students/writing-skills/phil-essay-guide>

1.

Emërtimi: Problemet kryesore të filozofisë moderne

Viti / semestri	Statusi	Ligjërata	Ushtrime	ECTS
I/II	Obligative	3	2	8

Objektivat dhe përmbajtja:

Ky kurs konsiston në përzgjedhjen dhe trajtimin e çështjeve kryesore të filozofisë moderne, duke e përfshirë periudhën e hershme (racionalizmi dhe empirizmi) dhe periudhën e vonshme (idealizmi klasik gjerman) të saj. Shqyrtimi dhe trajtimi i çështjeve mbështetet në interpretimin, krahasimin dhe paraqitjen e zhvillimit filozofik të epokës në fjalë. Ndër çështjet kryesore që shqyrtohen janë: problemi i metafizikës dhe kritika e saj; arsyeja dhe mendja; trupi, shpirti dhe fryma; problemi i njohës; vetëdija, vetëvetëdija dhe vetëpërcaktimi i subjektit; vullneti dhe liria; çështja e njeriut; çështja e zotit.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura (5-7) të mësimit:

Qëllimi i kursit është thellimi I njohurive mbi çështjet kryesore të trajtuara nga filozofët e periudhës moderne dhe relevanca e tyre filozofike, shkencore dhe kulturore. Njëkohësisht qëllimi i kursit është ndërlidhja në mes të njohurive të fituara gjatë studimeve në nivelin BA dhe ngritja e refleksionit mbi këto çështje në një nivel më të lartë teorik.

Studentët:

- janë aftësuar të kuptojnë, interpretojnë dhe diskutojnë në mënyrë të pavarur për problemet e trajtuara;
- janë të përgatitur t'i bartin njohuritë e fituara dhe të vazhdojnë studimin e mëtejshëm të filozofisë;
- janë të aftë të mendojnë dhe argumentojnë në mënyrë kritike.

Format e mësimit dhe mësuesit:

Do të mbështetet në ligjerata, diskutime dhe analizat e problemeve në ushtrime, përgatitjen e prezantimeve nga ana e studentve, interpretimin e teksteve filozofike dhe përgatitjen për kolokuiume.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:

Prezantime dhe/ose seminare:	30%
Aktiviteti në klasë:	10%
Provimi final:	60% ose
Kollokiumi i parë:	30%
Kollokiumi i dytë :	30%

Lartësia e notes varet nga përmbushja e këtyre pikave si dhe nga kuptuarit e problemeve, preciziteti, qartësia dhe shkathësia në të shprehurit dhe shkrim.

Shpërndarja e fondit të orëve në raport me ECTS:

1 ECTS=25 orë; 8 ECTS= 200 orë

Mjetet e konkretizimit/ TI:

Ligjërta; diskutime ne klasë; Prezantime. Seminare.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike te studimit:

Lënda do të kombinojë teorinë dhe praktikën gjatë secilit takim me studentë me qëllim të trajtimit të koncepteve dhe qasjeve themelore që kanë të bëjnë me këtë lëndë. Pjesa teorike do të fokusohet në teoritë kryesore të autorëve më relevant, kurse pjesa praktike do të realizohet nëpërmjet punës seminarike dhe në formë interaktive.

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

1. Routledge Encyclopedia of PHILOSOPHY, Volume I-IX, London and New York, (nacionet që trajtohen në këtë kurs);
 2. The Age of German Idealism, Routledge History of Philosophy, Volume VI, Edited by: Solomon C. Robert and Higgins M. Katheen;
 3. The Renaissance and 17-th Century Racionalizm, Routledge History of Philosophy, Volume IV;
 4. British Philosophy and the Age of Enlightenment, Routledge History of Philosophy, Volume V;
- ose ndonjë botim të historisë së filozofisë që mbulon periudhën e filozofisë moderne siç është ajo e Hegel-it, Windelband-it, Copleston-it etj.

2. Emërtimi: Teori e njohjes

Viti / semestri	Statusi	Ligjërata	Ushtrime	ECTS
I/II	Obligative	3	2	7

Objektivat dhe përmbajtja:

Kjo lëndë studion natyrën e njohjes dhe të së vërtetës. Gjatë semestrit në ligjërata, pra, do të shqyrtohen pikëpamjet tradicionale dhe ato bashkëkohore të së vërtetës, si dhe teoritë për raportin mes njohjes dhe realitetit, dhe tema të përafërta me to, si: dyshimi, dëshmia, verifikimi dhe rëndësi e veçantë i kushtohet justifikimit epistemik dhe teorive të tij: fondacionalizmi/koherentizmi, internalizmi/eksternalizmi, skepticizmi, etj. Do të trajtohen edhe metodat e modern epistemologjike dhe logjika epistemike. Vend i veçantë i jepet edhe debatit të tezës së T. Williamson se njohja vjen e para. Në *ushtrime* do të trajtohen tema nga antologjia: Sosa, E., Kim,

J., Fantl, J., and Matthew McGrath, (eds.) (2008). *Epistemology: An Anthology*. Malden: Blackwell Publishers.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura (5-7) të mësimit:

Kursi synon t'u sigurojë studentëve njohuri për konceptet dhe teoritë kryesore të epistemologjisë. Në fund të lëndës studentët do të kenë mësuar me kujdes definicionet dhe teoritë kryesore të kësaj fushe të filozofisë teorike dhe aftësohet të hulumtojë vetë në këtë fushë mbi bazën e përvojës së hulumtimit që merr këtë semestër nga kjo fushë.

Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies:

Mësimdhënja mbështetet në metodën e ligjërimit të mësimdhënsit mbi bazën e hulumtimeve, diskutimit dhe analizës së problemeve në seminare (ushtrime), përgatitjes së punimeve me shkrim nga ana e studentve, interpretimi i teksteve të kësaj fushe, dhe format tjera përkatëse për studimin e filozofisë.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:

Vlerësimi në këtë kurs është dizajnuar në atë mënyrë që tu ofrojë studentëve vazhdimisht informata se si janë duke përparuar dhe se ku duhet përforcuar konceptet.

Nota finale do të përllogaritet si më poshtë :

Përgatitjet për pjesëmarrje në klasë 20%

Detyrat me shkrim 20%

Provimi final me shkrim 60%

TOTAL 100%

Shpërndarja e fondit të orëve në raport me ECTS:

1 ECTS=25 orë; 7 ECTS= 175 orë.

45 orë ligjërata; 30 ushtrime; 100 orë: konsultime, seminare, prezantime dhe mësim individual për provimin final.

Mjetet e konkretizimit/ TI:

Për arritjen e rezultateve sa më të larta nga studentët, për realizimin e kursit, përveç librave dhe teksteve të nevojshme për ngritjen e cilësisë në shkrimin akademik do të përdoret edhe TI.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Kursi do të ketë 3 orë ligjerata dhe 2 orë ushtrime në javë. Njohuritë e ofruara gjatë ligjëratave do të diskutohen dhe sqarohen gjatë orëve të ushtrimeve, ku studentët do të kenë mundësi të verifikimit të njohurive të përvetësuara. Po ashtu, studentët do të realizojnë punën praktike përmes detyrave që do t'i kryejnë jashtë klasës (studimi i literatures në shtëpi, hulumtimi përmes TI etj.)

Do të stimulohet mësimi dhe avansimi i njohjes së gjuhës huaj.

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

1. Zagzebski, L. (2009). *On Epistemology*. Belmont: Wadsworth.
2. Feldman, R. (2002). *Epistemology*. Upper Saddle River: Prentice Hall.

3. Sosa, E., Kim, J., Fantl, J., and Matthew McGrath, (eds.) (2008). *Epistemology: An Anthology*. Malden: Blackwell Publishers.
4. Baumann, P. (2015). *Erkenntnistheorie: Lehrbuch Philosophie*. Stuttgart: Metzler.
5. Williamson, T. (2000). *Knowledge and its Limits*. Oxford: OUP.

3. Emërtimi: Hermeneutika filozofike

Viti / semestri	Statusi	Ligjërata	Ushtrime	ECTS
I/II	Obligative	2	2	5

Objektivat dhe përmbajtja:

Hermeneutika është përfshinë metodat e interpretimit të teksteve në fushat e ndryshme të dijeve humane. Ky kurs është një elaborim sistematik i çështjeve kryesore të hermeneutikës filozofike, duke filluar me elaborimin e dallimeve në mes saj dhe hermeneutikës në interpretimin e teksteve religjioze dhe atyre artistike. Pastaj në fokus të kursit do të jetë elaborimi i raportit të hermeneutikës me metodologjinë e shkencave sociale, si dhe qasjet e ndryshme hermenutike në filozofinë perëndimore, me theks në filozofinë kontinentale ku do të trajtohen autorët më të njohur të kësaj fushe siç janë Niçe, Hajdegeri, Gadameri, Rikeri, si dhe autorët e qasjes marksiste si Benjamini, Blohu dhe Jamesoni.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura (5-7) të mësimit:

Qëllimi i këtij kursi është që studentët e filozofisë në nivelin e studimeve master të marrin njohuri më të thelluara dhe më të specializuara mbi hermeneutikën filozofike, si dhe të fitojnë shkathtësitë themelore për interpretimin e teksteve filozofike.

1. Të kuptojë konceptet themelore të hermeneutikës filozofike.
2. Të njohë në mënyrë të thelluar qasjet dhe autorët e kësaj fushe të mendimit filozofik
3. Të jetë në gjëndje të ushtrijë në mënyrë të pavarur praktikën hermeneutike në leximin e teksteve filozofike.

Format e mësimit dhe mësimit:

Ligjërata, analizë të koncepteve, lexim të teksteve, punime seminarike dhe kolokiume

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:

Kolokium dhe provim final.

Shpërndarja e fondit të orëve në raport me ECTS:

1 ECTS=25 orë; 5 ECTS = 125 orë.

30 orë ligjëriata; 30 ushtrime; 65 orë: konsultime, seminare, prezantime dhe mësim individual për provimin final.

Mjetet e konkretizimit/ TI:

Ligjërata, Diskutime ne klasë; Prezantime seminarike.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike te studimit:

Lënda do të kombinojë teorinë (ligjërata) dhe praktikën (ushtrime) gjatë takimeve me studentë me qëllim të trajtimit të koncepteve dhe qasjeve themelore që kanë të bëjnë me këtë kurs. Pjesa teorike do të fokusohet në teoritë kryesore, kurse pjesa praktike do të realizohet nëpërmjet punës seminarike dhe në formë interaktive.

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

1. Nicholas Rescher, Interpreting philosophy: the elements of philosophical hermeneutics, ontos verlag, 2007.
2. Brice R. Wachterhauser, Hermeneutics and Modern Philosophy, State Univ of New York Press, 1986.

4.Emërtimi: Arti dhe shoqëria

Viti / semestri	Statusi	Ligjërata	Ushtrime	ECTS
I/II	Obligative	2	2	5

Objektivat dhe përmbajtja:

Arti dhe shoqëria është dizajnuar si një lëndë e cila trajton marrëdhënien e ndërsjellë midis artit dhe shoqërisë, e cila do të shkoqitet në tri pjesë:

1. Paranteza e parë: Marrëdhënia historike
2. Paranteza e dytë: Marrëdhënia shoqërore dhe kulturore
3. Paranteza e tretë: Marrëdhënia ideologjike dhe politike dhe konsekuencat kulturore

Qëllimet dhe rezultatet e pritura (5-7) të mësim:

Studentët përmes kësaj lënde duhet të kuptojnë “Ontologjinë” e Artit në raport me shoqërinë dhe dimenzionin thellësisht shoqëror të artit, në atë kuptim që arti nuk është thjeshtë “superstrukturë” e shoqërisë, por “konstituens i saj dhe dimenzion human shoqërisë.

Në aspektin edukativ, studentët duhet ta përdorin artin si faktor të fuqishëm për humanizimin dhe demokratizimin e shoqërisë, duke e parë atë në këtë rol edhe historikisht edhe aktualisht...

Pas përfundimit të kursit studentët duhet të kuptojnë dhe zbatojnë aspekte shoqërore- edukative mbi rolin e artit publik në transformimin e shoqërisë; Ata duhet të studjojnë literaturën, por edhe të frekventojnë ekspozita dhe veprimtari tjera artistike, me çrast duhet të shkruajnë dhe komentojnë ato veprimtari.

Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies:

Ligjerata përmes prezantimit visual (PP) shembuj dhe diskutime me studentë, si dhe prezantime tekstesh dhe dokumentarësh, vizita në muze dhe ekspozita arti...

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:

Lënda do të përmbajë 100 pikë që nënkupton suksesin e shkëlqyeshëm dhe ato pike duhet fituar 50% gjatë semestrit, me pjesëmarrje aktive dhe kryerje detyrash, kurse 50% tjetër do të fitohet në provimin përfundimtar me shkrim dhe me gojë;

91-100% shkëlqyeshëm; 81-90 %sh. Mire; 71-80% mire

61-70% kënaqëshëm; 51-60% mjafton, plotësohen kriteret minimale...

Shpërndarja e fondit të orëve në raport me ECTS:

1 ECTS=25 orë; 5 ECTS = 125 orë.

30 orë ligjërata; 30 ushtrime; 65 orë: konsultime, seminare, prezantime dhe mësim individual për provimin final.

Mjetet e konkretizimit/ TI:

Sllajde Power Point; diskutime në klasë; Prezantime seminarike.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Lënda do të kombinojë teorinë (ligjërata) dhe praktikën (ushtrime) gjatë takimeve me studentë me qëllim të trajtimit të koncepteve dhe qasjeve themelore që kanë të bëjnë me këtë kurs. Pjesa teorike do të fokusohet në teoritë kryesore, kurse pjesa praktike do të realizohet nëpërmjet punës seminarike dhe në formë interaktive.

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

1. Ernest H. Gombrich: The Story of Art, (Edhe në gj. Shqipe, bot. Fondacioni Soros 1996)
2. Matei Calinescu: Pesë fytyrat e modernitetit, Dituria, Tiranë- 2012

5/a Emërtimi: Filozofi e gjuhës

Viti / semestri	Statusi	Ligjërata	Ushtrime	ECTS
I/II	Zgjedhore	2	2	5

Objektivat dhe përmbajtja:

Qeniet njerëzore kanë aftësinë të reprezentojnë përmes gjuhës, që do të thotë se kanë mundësinë të japin një kuptim të veçantë symboleve të tyre (në kuptimin e përgjithshëm të fjalës *simbol*), të referojnë në botën e objekteve ekzistuese e joekzistuese, të transmetojnë një informatë duke përdorur lidhje të plotëkuptimita mes fjalëve, dmth. duke përdorur fjali të formave të ndryshme (të ligjëratës së drejtë dhe të zhdrejtë etj.), me qëllim që të thonë diçka për botën nëpërmjet gjuhës, por njëzot kanë aftësinë gjithashtu edhe të realizojnë akte përmes gjuhës etj. Në këtë lëndë do të shqyrtojmë disa teori të kuptimit, referencës dhe të së vërtetës dhe si dhe teorinë e përemrave. Prej filozofëve që ne do të studjojmë janë Gottlob Frege, Bertrand Russell, Ludwig Wittgenstein, W. V. O. Quine, Donald Davidson, H. P. Grice, Saul Kripke, John Searle dhe David Kaplan etj.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura (5-7) të mësimin:

Në këtë lëndë studentët duhet të diskutojnë dhe analizojnë problemet dhe teoritë kryesore filozofike mbi natyrën e gjuhës dhe të kuptimit.

Në ligjërata e ushtrime (seminare) do të përpiqemi që studentët të kenë këto rezultate:

Të zhvillojnë aftësinë për të lexuar, interpretuar dhe analizuar tekste filozofike të filozofëve të mëdhenj të gjuhës si ata që përmendëm më lart në përshkrimin e lëndës.

Të mendojnë në mënyrë kritike për tekstet që duhet lexuar.

Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies:

Mësimdhënja mbështetet në metodën e ligjërimit të mësimdhënsit mbi bazën e hulumtimeve, diskutimit dhe analizës së problemeve në seminare (ushtrime), përgatitjes së punimeve me shkrim nga ana e studentve, interpretimi i teksteve të kësaj fushe, dhe format tjera përkatëse për studimin e filozofisë.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:

Vlerësimi në këtë kurs është dizajnuar në atë mënyrë që tu ofrojë studentëve vazhdimisht informata se si janë duke përparuar dhe se ku duhet përfortuar konceptet.

Nota finale do të përlogaritet si më poshtë :

Përgatitjet për pjesëmarrje në klasë 20%

Detyrat me shkrim 20%

Provimi final me shkrim 60%

TOTAL 100%

Shpërndarja e fondit të orëve në raport me ECTS:

1 ECTS=25 orë; 5 ECTS = 125 orë.

30 orë ligjëriata; 30 ushtrime; 65 orë: konsultime, seminare, prezantime dhe mësim individual për provimin final.

Mjetet e konkretizimit/ TI:

Për arritjen e rezultateve sa më të larta nga studentët, për realizimin e kursit, përveç librave dhe teksteve të nevojshme për ngritjen e cilësisë në shkrimin akademik do të përdoret edhe TI.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Kursi do të ketë 2 orë ligjerata dhe 2 orë ushtrime në javë. Njohuritë e ofruara gjatë ligjëratave do të diskutohen dhe sqarohen gjatë orëve të ushtrimeve, ku studentët do të kenë mundësi të verifikimit të njohurive të përvetësuara. Po ashtu, studentët do të realizojnë punën praktike përmes detyrave që do t'i kryejnë jashtë klasës (studimi i literatures në shtëpi, hulumtimi përmes TI etj.)

Do të stimulohet mësimi dhe avansimi i njohjes së gjuhës huaj.

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

1. Martinich, A.P. (ed.) (1996). *The Philosophy of Language*. 3rdedn., New York: Oxford University Press.
2. Lycan, W. G. (2008). *Philosophy of Language: A Contemporary Introduction*. 2nd edn., New York: Routledge.
3. Kaplan, D. (1989). "Demonstratives". In Joseph Almog, John Perry & Howard K. Wettstein (eds.), *Themes From Kaplan*. New York: Oxford University Press.
4. Miller, A. (2007). *Philosophy of Language*. 2nd edn., Ithaca, NY: McGill-Queens University Press.

5/b Emërtimi: Frege

Viti / semestri	Statusi	Ligjërata	Ushtrime	ECTS
I/II	Zgjedhore	2	2	5

Objektivat dhe përmbajtja:

Në *ligjëratat* e këtij kursi me një filozof të përzgjedhur parashihen të shqyrtohen këto tema: do të studjohen më për së afërmi veprat logjike dhe filozofike të filozofit dhe logjicentit gjerman Gottlob Frege-s (1848–1925). Temat që do të shqyrtohen janë: natyra e logjikës, natyra e numrit, objektet abstrakte, e vërteta, teoria e kuptimit, (dallimet që i bën Frege mes kuptimit dhe referencës si dhe mes konceptit/funksionit dhe objektit), padefinueshmëria e së vërtetës, natyra e mendimit, si dhe interpretimet mbi Fregen.

Në *ushtrime* pritet që të punohet me tekstet e Frege-s të përkthyer nga bartësi i lëndës: Bazat e aritmetikës, “Mbi kuptimin dhe domethënien”, “Mendimi”, “Mohimi”, si dhe nga teksti i përmendur te literatura që kërkohet për këtë lëndë. Por, studentëve do t’u ofrohen tekste edhe nga gjuha gjermane në rast se ata e zotërojnë këtë gjuhë.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura (5-7) të mësimit:

Për të mësuar interpretimin e teksteve me autorë të rëndësishëm klasik në historinë e filozofisë siç është Frege.

Në fund të kursit studentët do të jenë në gjendje të bëjnë në mënyrë të pavarur interpretimin e veprave të Freges nga shumë aspekte filozofike dhe logjike.

Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies:

Mësimdhënja mbështetet në metodën e ligjërimit të mësimdhënsit mbi bazën e hulumtimeve, diskutimit dhe analizës së problemeve në seminare (ushtrime), përgatitjes së punimeve me shkrim nga ana e studentve, interpretimi i teksteve të kësaj fushe, dhe format tjera përkatëse për studimin e filozofisë.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:

Vlerësimi në këtë kurs është dizajnuar në atë mënyrë që tu ofrojë studentëve vazhdimisht informata se si janë duke përparuar dhe se ku duhet përforcuar konceptet.

Nota finale do të përlogaritet si më poshtë :

Përgatitjet për pjesëmarrje në klasë 20%

Detyrat me shkrim 20%

Provimi final me shkrim 60%

TOTAL 100%

Shpërndarja e fondit të orëve në raport me ECTS:

1 ECTS=25 orë; 5 ECTS = 125 orë.

30 orë ligjëriata; 30 ushtrime; 65 orë: konsultime, seminare, prezantime dhe mësim individual për provimin final.

Mjetet e konkretizimit/ TI:

Për arritjen e rezultateve sa më të larta nga studentët, për realizimin e kursit, përveç librave dhe teksteve të nevojshme për ngritjen e cilësisë në shkrimin akademik do të përdoret edhe TI.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike te studimit:

Kursi do të ketë 2 orë ligjerata dhe 2 orë ushtrime në javë. Njohuritë e ofruara gjatë ligjëratave do të diskutohen dhe sqarohen gjatë orëve të ushtrimeve, ku studentët do të kenë mundësi të verifikimit të njohurive të përvetësuar. Po ashtu, studentët do të realizojnë punën praktike përmes detyrave që do t'i kryejnë jashtë klasës (studimi i literatures në shtëpi, hulumtimi përmes TI etj.)

Do të stimulohet mësimi dhe avansimi i njohjes së gjuhës huaj.

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

Literatura kryesore që kërkohet për këtë lëndë bazohet në përkthimet e bartësit të lëndës, të përmendura në përshkrimin e lëndës në gjuhën shqipe si dhe në antologjinë: Michael Beaney, ed., *The Frege Reader* (Blackwell 1997).

Sluga, H. (1980). *Gottlob Frege: The Arguments of the Philosophers*. London: Routledge.

Kenny, A. (2000). *Frege: An Introduction to the Founder of Modern Analytic Philosophy*. Blackwell.

1. Emërtimi: Filozofi e moralit

Viti / semestri	Statusi	Ligjërata	Ushtrime	ECTS
I/III	Obligative	2	2	7

Objektivat dhe përmbajtja:

Së pari, do të paraqitet përkufizimi i nocionit dhe lëndës së filozofisë së moralit, etikës, pastaj do të trajtohen kategoritë themelore të etikës, ndarja e saj në degë (si etika deskriptive , etika normative, meta etika, etika aplikative dhe etiket speciale) dhe drejtime kryesore etike. Në fokus të këtij kursi do të jetë çështja e interpretimit, sajimit dhe argumentimit në fushën e filozofisë së moralit, kështu do të paraqiten ato doktrina, modele teorike dhe drejtime etike që e kanë dhënë kontributin kryesor në shtjellimin e kësaj problematike. Në këtë drejtim, do të shtjellohen rrymat, përfaqësuesit (autoret) dhe pikëpamjet kryesore të meta etikës (si teori për domethëniet e gjuhës morale). Përndryshe, një nga drejtimet më produktive (sidomos sa i përket publikimeve) dhe dominante në etikën bashkëkohore. Pastaj, vëmendja dhe hapësira kryesore në këtë kurs do të kushtohet etikës normative dhe drejtimeve të sajë, siç është ai teleologjikë (etika e qëllimeve dhe të mirës më të lartë) dhe ai deontologjikë (etika e detyrës, imperativit, primatit të normës). Si përfaqësues të drejtimit teleologjikë do të trajtohet: teoria etike e Aristotelit, eudajmonizmi, utilitarizmi dhe etika e vlerave të Shelerit dhe Hartmanit. Si përfaqësues të drejtimit deontologjikë do të përpunohet: teoria e Kantit për moralin, etika e diskursit(K.O. Apel dhe J. Habermas) , kontraktualizmit (Hobsi, Rusoja etj.), J. Roullsit (Raëls) etj. Në bllokun e fundit do të trajtohen çështje që kanë të bëjnë me zhvillimet reja në fushën e etikës aplikative , e sidomos do të theksohet aktualiteti dhe rëndësia e bioetikës dhe etikës ekologjike etj.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura (5-7) të mësimit:

Qëllimi i kursit është aftësimi i studentëve: për të kuptuar dhe përdorur konceptet themelore të filozofisë së moralit; për të kuptuar dhe interpretuar saktë tekstet etike-filozofike; për të krahasuar, vlerësuar dhe gjykuar drejt për doktrinat e ndyshme etike; për të diskutuar dhe vlerësuar drejt veprimet morale, si ato vetanake ashtu dhe ato të tjerëve. Qëllimi i fundit është aftësimi i kandidatve për mësimdhënje të filozofisë (pjesë e cilës është edhe filozofia e moralit) në shkolla, si dhe aftësimi i tyre për studim dhe hulumtim në mëtejshmë në lëmë.

Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies:

Mësimdhënja mbështetet në metoden e ligjerimit të mësimdhënies , diskutimit dhe analizës së problemeve në seminare (ushtrime), përgatitjes së punimeve me shkrim nga ana e studentve, interpretimi i teksteve të kësaj fushe, dhe format tjera përkatëse për studimin e filozofisë.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:

Vlerësimi në këtë kurs është dizajnuar në atë mënyrë që tu ofrojë studentëve vazhdimisht informata se si janë duke përparuar dhe se ku duhet përforcuar konceptet. Nota finale do të përlogaritet si më poshtë :

Përgatitjet për pjesëmarrje në klasë 20%

Detyrat me shkrim 20%

Provimi final me shkrim 50%

Pjesëmarrja dhe aktiviteti në klasë 10%

TOTAL 100%

Shpërndarja e fondit të orëve në raport me ECTS:

1 ECTS=25 orë; 7 ECTS= 175 orë.

30 orë ligjëriata; 30 ushtrime; 115 orë: konsultime, seminare, prezantime dhe mësim individual për provimin final.

Mjetet e konkretizimit/ TI:

Për arritjen e rezultateve sa më të larta nga studentët, për realizimin e kursit, përveç librave dhe teksteve të nevojshme për ngritjen e cilësisë në shkrimin akademik do të përdoret edhe TI.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Lënda do të kombinojë teorinë (ligjëriata) dhe praktikën (ushtrime) gjatë takimeve me studentë me qëllim të trajtimit të koncepteve dhe qasjeve themelore që kanë të bëjnë me këtë kurs. Pjesa teorike do të fokusohet në teorinë kryesore, kurse pjesa praktike do të realizohet nëpërmjet punës seminarike dhe në formë interaktive.

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

1. James Rachels & Stuart Rachels, Elementet e filozofisë morale, Tiranë : Dita 2000; ISP, 2009.
2. Simon Blackburn, Etika: një hyrje e shkurtër. Prishtinë: Cuneus, 2018.
3. Peter Singer, A Companion to Ethics. Oxford: Blackwell, 1991.

2. Emërtimi: Filozofi sociale

Viti / semestri	Statusi	Ligjërata	Ushtrime	ECTS
I/III	Obligative	2	2	7

Objektivat dhe përmbajtja:

Kursi fillimisht trajton traditën juridiko-natyrore, kontraktualizmin, konsekuencat socio-filozofike të nocionit të natyrës njerëzore dhe ligjit natyror. Mëtuqte shqyrtohet koncepti liberal të individit dhe shoqërisë në raport me konceptin komunitarist në kontekstin filozofiko-historik duke u bazuar në teoritw e: Locke, Kant, Rawls, Rousseau, Hegel, Taylor.

Pjesa e fundit të kursit është e orientuar drejtë debateve bashkohore në filozofinë sociale të çështjeve si: identiteti, diversiteti, liria dhe të drejtat, toleranca religjioze dhe sekularizmi, etika ambientaliste.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura (5-7) të mësimit:

Qëllimi i lëndës është të zhvillojë aftësinë e studentëve për të menduar në mënyrë kritike, analitike dhe praktike mbi individin dhe shoqërinë duke u bazuar në njohuritë dhe të kuptuarit e nocioneve kryesore filozofike.

Në fund të kursit studentët do të jenë në gjendje të:

- Mendojnë në mënyrë kritike, praktike dhe analitike mbi individin dhe shoqërinë
- Hulumtojnë dhe shfrytëzojnë literaturën nga fusha e ofruar
- Aplikojnë njohuritë e fituara në jetën e përditëshme.

Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies:

Ligjerata, ushtrime, seminare, prezantime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:

Vlerësimi në këtë kurs është dizajnuar në atë mënyrë që tu ofrojë studentëve vazhdimisht informata se si janë duke përparuar dhe se ku duhet përforcuar konceptet.

Nota finale do të përlllogaritet si më poshtë:

Prezantime apo seminare 30%

Provimi final me shkrim 60%

Pjesëmarrja dhe aktiviteti në klasë 10%

TOTAL 100%

Shpërndarja e fondit të orëve në raport me ECTS:

1 ECTS=25 orë; 7 ECTS= 175 orë.

30 orë ligjërata; 30 ushtrime; 115 orë: konsultime, seminare, prezantime dhe mësim individual për provimin final.

Mjetet e konkretizimit/ TI:

Ligjërata, ushtrime, prezantime ne grup

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike te studimit:

Lënda do të kombinojë teorinë dhe praktikën gjatë takimeve me studentë me qëllim të trajtimit të koncepteve dhe qasjeve themelore që kanë të bëjnë me këtë kurs. Pjesa teorike do të fokusohet në

teoritë kryesore, kurse pjesa praktike do të realizohet nëpërmjet punës seminarike dhe në formë interaktive.

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

1. Ilazi, Hasnije, Njeriu shumëdimensional (dhe përsiatje tjera mbi identitetin modern), Pema, Prishtinë, 2019
2. Sterba, James P. Social and Political Philosophy (Contemporary Perspectives, Routledge, London and New York, 2001
3. Thomas, Laurence, Contemporary Debates in Social Philosophy, Bleckwell, 2008

3.Emërtimi: Autorët e përzgjedhur nga filozofia bashkëkohore

Viti / semestri	Statusi	Ligjërata	Ushtrime	ECTS
I/III	Obligative	2	2	6

Objektivat dhe përmbajtja:

Kursi trajton filozofinë franceze Michel Foucault. Michel Foucault përfaqëson me mendim origjinal dhe të thelluar në boshtin e ngjizur iluminist mes dijes dhe pushtetit. Analizat e Foucault-së janë rëndësishme posaçërisht në fushën e trajtimit të pushtetit në modernitet. Mendimet Michel Foucault-së shpërbëjnë krejtësisht paradigmat klasike ose tradicionale të pushtetit.

Lënda ka për qëllim aftësimin e studentëve për refleksion mbi metodat arekologjike dhe gjenealogjike të koncepteve të dijes dhe pushtetit.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura (5-7) të mësimit:

Në këtë modul:

- Studentët do të kenë mendim të thelluar për konceptet e dijes dhe pushtetit;
- Studentët do të mund të identifikojnë në mënyrë metodologjike karakterin difuziv dhe dispersiv të pushtetit.

Format e mësimit dhe mësuesit:

Ligjërata dhe Diskutime

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:

Studenti vlerësohet në fund të semestrit në provim me gojë

Metodat e vlerësimit:

Pjesëmarrja në mësim	15%
Angazhimet në ushtrime	35%
Provimi final	50%

Shpërndarja e fondit të orëve në raport me ECTS:

Shpërndarja e fondit të orëve në raport me ECTS: 1 ECTS=25 orë; 6 ECTS= 150 orë.

Nga to: 30 orë ligjeriata; 30 ushtrime; 90 orë: konsultime, seminare, prezantime dhe mësim individual për provimin final.

Mjetet e konkretizimit/ TI:

Ligjërata të avancuara dhe ushtrime me tekste dhe interpretim i tyre

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike te studimit:

Lënda do të kombinojë teorinë (ligjërata) dhe praktikën (ushtrime) gjatë takimeve me studentë me qëllim të trajtimit të koncepteve dhe qasjeve themelore që kanë të bëjnë me këtë kurs. Pjesa teorike do të fokusohet në teoritë kryesore, kurse pjesa praktike do të realizohet nëpërmjet punës seminarike dhe në formë interaktive.

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

1. Michel Foucault, Disiplinë dhe ndëshkim, bot. Odeon, Tiranë- 2010
2. Michel Foucault, Pushteti dhe Dija, ISP&Dita, Tiranë Michel Foucault, Pushteti dhe Dija, ISP&Dita, Tiranë, 2009.
3. Michel Foucault, Historia e marrëzisë në kohën klasike, Toena, Tiranë, 2003

4/a

Viti / semestri	Statusi	Ligjërata	Ushtrime	ECTS
II/I	Zgjedhore	2	2	5

Objektivat dhe përmbajtja:

Zhvillimet e përgjithshme shoqërore në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar dhe këtij fillimshkulli prodhuan efekte të shumëfishta duke prekur një mori sferash shoqërore, si: politikën, kulturën, ekonominë, shkencën, teknologjinë, mediat etj. Këto efekte prodhuan ndryshime të tilla në strukturën dhe organizimin shoqëror, duke krijuar një realitet social, për shpjegimin e të cilit teoritë klasike ndihen gjithnjë e më të pafuqishme. Kjo prodhoi si nevojën e rimendimit të qasjeve teorike ashtu edhe të ndryshimeve konceptuale. Në këtë kuptim, kursi prek autorët kryesorë bashkëkohorë si dhe temat dhe konceptet qendrore, me të cilat ata përpiqen të shpjegojnë realitetin social të botës bashkëkohore duke e vendosur atë në target të kritikës teorike. Kursi në masë të madhe është i përqendruar në traditën franceze, me autorë të njohur si Foucault, Baudrillard, Derrida, Lyotard, Deleuze, Guattari dhe Lacan, por edhe të tjerë si Beck dhe Bauman, e të cilët në masë të madhe identifikohen me kampin e kritikës radikale postmoderne ndaj modernitetit, e po ashtu edhe autorë, të cilët kritikën shoqërore e artikulojnë në kuadër të paradigmës së modernizmit, si Habermas, Giddens etj. Fokusi i përbashkët teorik i këtyre autorëve janë dilemat e shumta shoqërore, politike e kulturore, të cilat u shfaqën pas luftës së dytë botërore, e të cilat destabilizuan besimet iluministe për trajektoren njëlineare të emancipimit modernist. Disa konsideronin se modernja ka kollapsuar si metarrëfim absolutist dhe universalist, i përligjur me optimizmin iluminist për shpëtimin dhe emancipimin e njeriut ndërsa disa të tjerë vazhdojnë të besojnë në projektin modernist të emancipimit racional të njeriut dhe shoqërisë.

Në këtë kuptim, ky kurs ka për qëllim:

- Shpjegimin e kontekstit historik dhe teorik të teorive kritike bashkëkohore;
- Trajtimin e koncepteve bazë, përmes të cilave autorët bashkëkohorë mëtojnë ta rikonceptualizojnë realitetin gjithnjë e më të komplikuar shoqëror;
- Të ngris kapacitetin kritik te studentët dhe t'i bëjë të ndjeshëm ndaj kompleksitetit të jetës shoqërore;

Pas përfundimit me sukses të kursit, studentët do të jenë në gjendje të:

- të kuptojnë të përbashkëtat dhe dallimet e qasjeve kritike bashkëkohore;
- të reflektojnë në mënyrë kritike për realitetin bashkëkohor;
- t'i aplikojnë konceptet e teorive kritike bashkëkohore në të kuptuarit dhe shpjeguarit e realitetit bashkëkohor;

Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies:

Ligjëratë– duhet të jeni të rregullt në vijimin e ligjëratave dhe konform planifikimit javor të lëndës, duhet të lexoni paraprakisht materialet e parapara me syllabus. Kjo ju lehtëson dukshëm përcjelljen aktive të ligjëratës dhe përvetësimin sa më të suksesshëm të njësisë përkatëse;

Recension/Seminar – ju duhet t'i bëni recension ndonjë libri (jo domosdoshmërisht prej atyre të listuar në syllabus – jo vetëm që jeni të lirë, por edhe inkurajoheni të hulumtoni për libra tjerë që ndërlidhen me tematikën sociologjike të paraparë me këtë syllabus), tematika e të cilit lidhet me përmbajtjen e kursit ose të zgjidhni një temë për punim seminarik, që po ashtu ndërlidhet me tematikën e kursit. Recensionin, përkatësisht seminari duhet të prezantohet për diskutim, ndërsa qasja (si në shkrim ashtu edhe në prezentim) duhet reflektojë qëndrimin tuaj kritik.

Diskutim – pjesëmarrja aktive dhe angazhimi konstruktiv i juaji gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve me ide, koncepte, pikëpamje etj. të mbështetura në argumente, inkurajohet fuqishëm, sidomos në diskutimin e prezantimeve të studentëve tjerë.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:

			Nota	Përshkrimi	Pikët
Diskutimet ne klase %	10		10 (A)	Shkëlqyeshëm	91-100
Recensionin dhe prezentimi %	20		9 (B)	Shumë mirë	81-90
Kollokvium %	30		8 (C)	Mirë	71-80
Testi final %	40				
			7 (D)	Mjaftueshëm	61-70
			6 (E)	Kaloi	51-60

Total	100	5	(F,F X)	Nuk kalon, kriteri I pamjaftueshëm	nën 51
--------------	------------	----------	--------------------	---	---------------

Shpërndarja e fondit të orëve në raport me ECTS: 1 ECTS=25 orë; 5 ECTS = 125 orë.
30 orë ligjeriata; 30 ushtrime; pjesa tjetër: konsultime; kolokvijume, seminare; mësim individual;
prezentime.

Mjetet e konkretizimit/ TI:

Power Point; Lexime paraprake dhe diskutime ne klase; shfaqje e inserteve të ndryshme filmike.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike te studimit:

Përpos pjesës teorike, ligjëratave, kursi përmban edhe pjesën e ushtrimeve, ku me raste konkrete problematizohen teoritë kritike.

LITERATURA

Literatura obligative:

1. Ritzer, George (1997) Postmodern Social Theory. New York: The McGraw-Hill.
2. Ritzer, George & Goodman, Douglas (2008) Teoria Sociologjike. Tiranë: UFO.

4/b Emërtimi: Filozofi e të drejtave të njeriut

Viti / semestri	Statusi	Ligjërata	Ushtrime	ECTS
I/III	Zgjedhore	2	2	5

Objektivat dhe përmbajtja:

Lënda ka për qëllim t'i kuptojnë karakteristikat dhe kategoritë e ndryshme të të drejtave të njeriut si dhe t'i studiojë bazat filozofike dhe historike të këtyre të drejtave. Kjo lëndë synon të kuptojë fushën e gjerë dhe komplekse të të drejtave të njeriut. Lënda ka të bëjë me burimet, kategoritë, përmbajtjen dhe kufijtë e të drejtave të njeriut, si dhe obligimet që ato krijojnë për shtetin. Ajo gjithashtu analizon mekanizmat kryesorë të zbatimit të tyre në nivel universal. Që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore, të drejtat e njeriut kanë qenë në qendër të demokratizimit të shoqërive demokratike. Shumë çështje sot debatohen nën flamurin e të drejtave të njeriut sic janë: mbrojtja e pakicave, lufta kundër diskriminimit të grave, të drejtat LGBT), lufta kundër torturës dhe zhdukjes me forcë, lufta kundër varfërisë ose mbrojtja e mjedisit dhe mbrojtja e të dhënave.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura (5-7) të mësim:

- krijojnë bazën e njohurive në fushën e filozofisë së të drejtave të njeriut.
- të kuptojnë zhvillimin historik të idesë së filozofise se te drejtave te njeriut
- të analizojnë se pse këto të drejta janë të rëndësishme;
- të jenë në gjendje t'i identifikojnë instrumentet që kanë për qëllim t'i mbrojnë ato;
- të jenë në gjendje të kuptojnë se si shfrytëzohen këto të drejta;

- të kuptojnë mekanizmat të cilët ekzistojnë për t'i zbatuar ato si dhe të dallojnë avantazhet dhe disavantazhet e tyre.
- Të identifikojnë se cka e bën të mundur ose e pengon kapacitetin e qytetarit që të marrë pjesë në çështjet publike;
- Të bëjë lidhjen ndërmjet te drejtave të njeriut dhe pjesëmarrjes civile në proceset politike.

Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies:

Lënda do të zhvillohet përmes ligjëratave, prezentimeve, prezentimeve në grup, leximeve, seminareve.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:

			Nota	Përshkrimi	Pikët
Diskutimet në klasë %	15	10	(A)	Shkëlqyeshëm	91-100
Prezantimi i një konflikti %	30	9	(B)	Shumë mirë	81-90
Hulumtimi dhe punimi perfundimtar %	55	8	(C)	Mirë	71-80
		7	(D)	Mjaftueshëm	61-70
		6	(E)	Kaloi	51-60
Total	100	5	(F,FX)	Nuk kalon, kriteri I pamjaftueshëm	nën 51

Shpërndarja e fondit të orëve në raport me ECTS:

Shpërndarja e fondit të orëve në raport me ECTS: 1 ECTS=25 orë; 5 ECTS = 125 orë.

30 orë ligjëriata; 30 ushtrime; 15 orë konsultime; 10 orë kolokviume dhe seminare; 10 orë mësim individual; 10 prezentime.

Mjetet e konkretizimit/ TI:

Sllajde Power Point; diskutime në klasë; Prezantime në grup.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Lënda do të kombinojë teorinë (ligjëratat) dhe praktikën (ushtrime) gjatë takimeve me studentë me qëllim të trajtimit të koncepteve dhe qasjeve themelore që kanë të bëjnë me filozofinë e të drejtave të njeriut. Pjesa teorike do të fokusohet në teoritë kryesore të autorëve më relevant të drejtave të njeriut kurse pjesa praktike do të realizohet nëpërmjet punës seminarike dhe në formë interaktive.

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

1. Samuel Moyn, The Last Utopia: Human Rights in History, Harvard University Press, 2010.
2. Sally Engle Merry, Human Rights and Gender Violence: Translating International Law into Local Justice. Chicago University Press, 2006.
3. Sally Engle Merry et Mark Goodale, The Practice of Human Rights: Tracking Law Between the Global and the Local, Cambridge University Press, 2007

5/a Emërtimi: Filozofi e arkitekturës

Viti / semestri	Statusi	Ligjërata	Ushtrime	ECTS
I/III	Zgjedhore	2	2	5

Objektivat dhe përmbajtja:

Kursi është konceptuar që të mundësojë studentët që të bëjnë ndërlidhjen mes koncepteve bazë të filozofisë moderne - postmoderne dhe arkitekturës. Arkitektura moderne kontekstualizohet brenda një formacioni më të gjerë kuptimor të interpretimit të themeluar mbi premisat që konstitujnë identitetin e modernes si një epokë e mvetësishme. Po ashtu edhe arkitektura postmoderne vjen si shprehje e veçuar e shpërbërjes së premisave themelore të modernes. Të dyja shprehjet në projektimin arkitektonik janë pjesë e diskurseve të konfrontuara të njohura si moderne dhe postmoderne. Me këtë kurs studentët duhet arrijnë deri te njohuritë e nevojshme për identifikimin e diskurseve të cilat kushtëzojnë orientimet e arkitekturës së shek. XX dhe XXI.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura (5-7) të mësimit:

Njohja themelore mbi programin dhe projektin e filozofisë dhe arkitekturës.

1. Të arrijë të diferencojë konceptualisht arkitekturën moderne nga arkitektura postmoderne.
2. Të informohet për kontekstin më të gjerë të shprehjes arkitektonike si pjesë e një diskursi të caktuar teorik ose si shprehje e një formacioni diskursiv.

Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies:

Ligjërata e avancuar dhe diskutime

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:

Pjesëmarrja në mësim	10%
Angazhimet në ushtrime	15%
Provimi me test	30%
Provimi me gojë	45%

Shpërndarja e fondit të orëve në raport me ECTS:

1 ECTS=25 orë; 5 ECTS = 125 orë.

30 orë ligjeriata; 30 ushtrime; 65 orë: konsultime, seminare, prezantime dhe mësim individual për provimin final.

Mjetet e konkretizimit/ TI:

Ligjërata të avancuara dhe ushtrime me tekste dhe interpretim i tyre

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Lënda do të kombinojë teorinë (ligjërata) dhe praktikën (ushtrime) gjatë takimeve me studentët me qëllim të trajtimit të koncepteve dhe qasjeve themelore që kanë të bëjnë me këtë kurs. Pjesa teorike do të fokusohet në teoritë kryesore, kurse pjesa praktike do të realizohet nëpërmjet punës seminarike dhe në formë interaktive.

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

1. Astrit Salihu, Lexim Filozofik i Arkitekturës, SHFK/Prishtinë, 2018
2. Le Corbusier, Drejt një arkitekture, Phoenix/Tiranë, 2000.
3. Charles Jencks, Modern Movement in Architecture, Penguin Books LTD, 1973.

5/b Emërtimi: Filozofi e mediave

Viti / semestri	Statusi	Ligjërata	Ushtrime	ECTS
I/III	Zgjedhore	2	2	5

Objektivat dhe përmbajtja:

Përgjatë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar proceset e zhvillimit të hovshëm teknologjik kanë gjeneruar edhe procesin e rritjes së shpejtë të ndikimit të mediave në jetën individuale dhe sociale. Ky ndikim ka ardhur aq shumë duke u rritur sa shumë vëzhgues të zhvillimeve sociale, politike e kulturore kanë konstatuar se si pasojë e këtij ndikimi ka ndërruar edhe modeli i shoqërisë dhe tash kemi hyrë në atë që disa e quajnë “shoqëri informative”, disa “shoqëri e spektaklit” e disa “shoqëri postmoderne”. Në këtë kurs ne do të ndalemi në refleksionet e dy mendimtarëve lidhur me raportin e mediave me shoqërinë dhe kulturën. Njëri është Marshall McLuhan dhe tjetri Jean Baudrillard. Me aspektin e zhvillimit dhe rritjes së fuqisë së mediave merret filozofia e McLuhan. Zhvillimi i mediave, sidomos atyre elektronike, sipas McLuhan, i ka dhënë dimensione të papara më herët shoqërisë dhe kulturës njerëzore, identiteve të saj, duke zhvendosur njerëzimin nga “bazamenti tribal” i identitetit në të ashtuquajturin “fshati global”. Pjesë e shqyrtimit të pikëpamjeve të McLuhan për mediat do të jetë edhe ideja e tij që i sheh mediat si zgjatim i qenies njerëzore. Teoria e Baudrillard për mediat është ajo që njihet si “Teoria e simulacionit”, një teori e cila konsideron se zhvillimi i madh i mediave, sidomos mediave elektronike, ka krijuar fenomenin e hiper-realityt, një botë e imazheve, shenjave dhe kodeve që është konstituar si një botë autonome, pa asnjë referencë në atë që në konceptin tradicional quhet realitet.

Aftësimi i studentëve për qasje analitike në problematikën e mediave

Qëllimet dhe rezultatet e pritura (5-7) të mësimit:

Në fund të kursit studentët do të aftësohen për të reflektuar rolin, domethënien dhe kuptimin e medias në shoqëritë bashkëkohore.

Format e mësimit dhe mësuesit:

Ligjërata dhe Diskutime

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:

Studenti vlerësohet në fund të semestrit në provim me gojë

Metodat e vlerësimit:

Pjesëmarrja në mësim	15%
Angazhimet në ushtrime	35%
Provimi final	50%

Shpërndarja e fondit të orëve në raport me ECTS:

1 ECTS=25 orë; 5 ECTS = 125 orë.

30 orë ligjeriata; 30 ushtrime; 65 orë: konsultime, seminare, prezantime dhe mësim individual për provimin final.

Mjetet e konkretizimit/ TI:

Për arritjen e rezultateve sa më të larta nga studentët, për realizimin e kursit, përveç librave dhe teksteve të nevojshme për ngritjen e cilësisë do të përdoret edhe TI.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike te studimit:

Lënda do të kombinojë teorinë (ligjërata) dhe praktikën (ushtrime) gjatë takimeve me studentë me qëllim të trajtimit të koncepteve dhe qasjeve themelore që kanë të bëjnë me këtë kurs. Pjesa teorike do të fokusohet në teoritë kryesore, kurse pjesa praktike do të realizohet nëpërmjet punës seminarike dhe në formë interaktive.

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

1. Marshal McLuhan, Understanding Media, Rouldege/London 2005
2. Jean Baudrillard, Simulations and Simulacra, MICHIGAN/ 1990
3. Jean Baudrillard, The Gulf War Did Not Take Place, Indiana University Press 1995.

1. Emërtimi: Punim diplome

Viti / semestri	Statusi	Ligjërata	Ushtrime	ECTS
I/IV	Obligative	---	---	30

Objektivat dhe përmbajtja:

Objekivi i punimit të diplomës është që studentin në kohë racionale dhe në mënyrë të pavarur, por nën mbikëqyrjen e një profesori me thirrje së paku Prof. Ass. Dr., të hulumtojë për një temë të ngushtë filozofike duke u bazuar në literaturën relevante, ta elaborojë atë në mënyrë analitike ose interpretuese dhe ta artikulojë atë në mënyrë të shkruar sipas rregullave standarde të shkrimit akademik në filozofi me një vëllim të së paku 80 faqeve standarde DinA4 me largësi të rreshtave 1,5.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura (5-7) të mësimit:

Qëllimi i punimit të diplomës është që studentin të tregojë që ka aftësinë për të punuar në mënyrë të pavarur shkencore nën mbikëqyrjen e një profesori për një temë të caktuar filozofike.

Rezultatet e pritura që studentin:

- të aftësohet që të punojë në hulumtim në mënyrë të pavarur, por në mbikëqyrjen e një profesori
- që të artikulojë mendimet e tij origjinale për një temë të caktuar
- që të aftësohet të punojë në mënyrë shkencore për një temë filozofike
- që të analizojë dhe të interpretojë tekste dhe argumente filozofike dhe t'i prezantojë ato në mënyrë të shkruar
- që punën origjinale ta prezantojë para një komisioni profesional dhe publikut.

Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies:

Punë vetanake e kandidatit nën mbikëqyrjen e një profesori dhe prezantim i saj para komisionit prej 3 profesorësh: mentorit, tënjë anëtarit dhe kryetarit të komisionit (prezantimi i hapur për publikun).

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:

Anëtarët e komisionit e vlerësojnë punimin e masterit dhe prezantimin e kandidatit me gojë.

Shpërndarja e fondit të orëve në raport me ECTS:

1 ECTS=25 orë ngarkese për studentin; 30 ECTS= 750 orë ngarkese për studentit. 27 ECTS për punimin e tezës së masterit, kurse 3 ECTS përgatitje për mbrojtjen.

Mjetet e konkretizimit/ TI:

Për arritjen e rezultateve sa më të larta nga studentët, për realizimin e tezës së masterit, përveç librave dhe teksteve të nevojshme për ngritjen e cilësisë në shkrimin akademik do të përdoret edhe TI.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike te studimit:

Punë e pavarur e studentit-es e së paku 80 faqeve të shkruara standarde DIN A4 me lagësi 1.5 mes rreshtave dhe mbrojtja me gojë e punimit para një komisioni të 3 profesorëve (prezantim i hapur publik).

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

Literatura relevante për temën ku fokusohet studenti.

1.4. Studentët

Standardi 5.1. Ekziston një procedurë e pranueshme e pranuar zyrtarisht në nivel institucional që programi i studimit respekton gjatë organizimit të rekrutimit të studentëve. Kërkesat për pranim aplikohen në mënyrë të vazhdueshme dhe të drejtë për të gjithë studentët.

Pranimi i studentëve të rinjë bëhet sipas rregullave të Statutit të UP-së dhe konkursit publik të shpallur në shtypin ditor dhe në ueb-faqe të Universitetit të Prishtinës. Numri i kandidatëve që pranohen çdo vit në programin e filozofisë është i përcaktuar me dokumentin e akreditimit dhe deri me tani ka qenë 40. Kriteret bazë për regjistrim të studentëve janë: përfundimi me sukses dhe nota mesatare mbi 8.5. në studimet themelore, njohja e ndonjë nga gjuhë botrore dhe kalimi me sukses i provimit pranues të cilit duhet t'i nënshtrohen të gjithë studentët që aplikojnë. Testi pranues përmban pyetje nga fusha e filozofisë.

Standardi 5.2. Të gjithë studentët e regjistruar në programin e studimeve posedojnë një diplomë të diplomës së shkollës së mesme ose një dokument tjetër ekuivalent studimi, sipas kërkesave të MASHT-it.

Studentët duhet të posedojnë diplomë valide të shkollës së mesme ose një dokument tjetër ekuivalent studimi në përputhje me kriteret e përcaktuara nga MASHT.

Standardi 5.3. Grupet e studimit janë dimensionuar në mënyrë që të sigurojnë një proces efektiv dhe interaktiv të mësimdhënies dhe mësimin.

Programi parashih sigurimin e procesit efektiv dhe interaktiv të mësimdhënies dhe mësimin, ku në qendër të studimit është studenti. Angazhimi i studentëve do të jetë më evident gjatë pjesës së ushtrimeve dhe përmes punës individuale dhe në grupe, diskutimeve dhe prezantimeve. Numri i studentëve të regjistruar (40) siguron proporcionin adekuat në raport me stafin akademik, gjë që siguron punën cilësore dhe angazhimin e balancuar të stafit edhe në shpërndarjen e mentorimit të punimeve të diplomës.

Standardi 5.4. Reagimi ndaj nxënësve mbi performancën e tyre dhe rezultatet e vlerësimeve jepet menjëherë dhe shoqërohet me mekanizma për ndihmë nëse është e nevojshme.

Metodat e vlerësimit cilësor të studentëve janë të paraparë brenda syllabuseve të secilës lënde si dhe në programin e studimeve master. Me këtë mundësohet që studentët të jenë të informuar më kohë mbi procesin e vlerësimit. Njëkohësisht sigurohet që studentët të vlerësohen për performancën e tyre në mënyrë të vazhdueshme dhe të njoftohen për rezultatet e vlerësimit më kohë dhe përmes shpalljes publike dhe transparente të rezultateve.

Standardi 5.5. Rezultatet e fituara nga studentët gjatë gjithë cikleve të studimit janë të certifikuara nga të dhënat akademike.

Rezultatet e studenteve dhe sistemi i notimit janë të certifikuara dhe siguruara në sistemin elektronik SEMS si dhe ruhen në mënyrë fizike që të mbrohen e arkivohen si dhe janë në dispozicion vetëm për nevojat e studentit dhe të menaxhmentit të Universitetit.

Standardi 5.6. Trajtimi fleksibël i nxënësve në situata të veçanta është siguruar në lidhje me afatet dhe kërkesat formale në program dhe në të gjitha provimet.

Studentët në përputhje me Statutin e Universitetit, në raste të veçantë kanë mundësinë e kohëzgjatjes së shtuar të studimeve si dhe afateve të provimeve. Kjo nënkupton se kohëzgjatja e lejuar e studimeve mund të jetë jo më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes së studimeve, por me kërkesë të arsyetuar dhe miratuar nga Këshilli i studimeve të Fakultetit dhe në koordinim me menaxhmentin e Universitetit ky afat mund të shtyhet edhe për më tutje.

Standardi 5.7. Regjistrimet e niveleve të përfundimit të studentëve mbahen për të gjitha kurset dhe për programin në tërësi dhe përfshihen në mesin e treguesve të cilësisë.

Rezultatet e vlerësimi të studentëve në tërësi dhe sipas lëndëve individuale ruhen përmes programit SEMS ku notat sistemohen për të gjitha lëndet në pasqyrën e notave e cila shërben edhe si tregues i cilësisë, por edhe si vlerësim i përgjithshëm për studentët në veçanti. Kopje fizike të notave janë të arkivuara te referentë i programit master të Departamentit të Filozofisë.

Standardi 5.8. Procedurat efektive po përdoren për të siguruar që puna e paraqitur nga studentët është origjinale.

Janë ndërmarre masat e duhura që integriteti, cilësia si dhe aspektet etike të punës hulumtuese dhe të studimeve të jene të siguruar me qëllim të mbrojtës nga kopjimet ose keqpërdorimet të mundshme nga ana e studentëve. Për këtë ekzistojnë komisionet etike dhe disiplinore në nivel Fakulteti ku çdo shkelje raportohet dhe procedohet për shqyrtim. Njëkohësisht me rastin e mbrojtjes së punimit të diplomës studentët nënshkruajnë deklaratën mbi punën origjinale, pa të cilën deklaratë nuk mundësohet mbrojtja publike e punimit të diplomës.

Standardi 5.9. Të drejtat dhe detyrimet e studentëve bëhen publike, i promovohen të gjithë atyre që janë të interesuar dhe zbatohen në mënyrë të barabartë; këto do të përfshijnë të drejtën për apelimet akademike.

Ashtu siç parashihet me Statutin e UP-se, studentët njoftohen më kohë dhe gjerësisht për të drejtat dhe detyrimet e tyre me rastin e pranimit në Fakultet apo edhe me informata përkatëse online. Njëkohësisht studentët informohen për mundësitë e organet përkatëse përmes të cilëve mund t'i adresojnë ankesat e tyre në rast se nuk trajtohen në mënyrë të drejtë apo të barabartë. Studentët e kanë edhe Parlamentin Studentor, përmes të cilit përfaqësohen në Këshillin e Fakultetit Filozofik dhe komisione përkatëse, sikur dhe në nivelin e Universitetit.

Standardi 5.10. Transferimi i studentëve ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë, fakulteteve dhe programeve të studimit rregullohet qartë në dokumentet e brendshme formale.

Transferimi i studentëve është i rregulluar sipas normave ligjore dhe dispozitave statutore të Universitetit. Ekziston rregullore e posaçme për transferin e notave dhe ECTS-ve.

Standardi 5.11. Staf i akademik është i disponueshëm në kohë të mjaftueshme për këshillim dhe këshillim për studentët. Ndihma adekuate e tutorialit ofrohet për të siguruar mirëkuptimin dhe aftësinë për të aplikuar mësimin.

Oraret e konsultave të stafit janë të vendosura në dyert e zyrave të stafit akademik dhe në ueb-faqe te Fakultetit Filozofik. Ekziston edhe mundësia për këshillim, mentorim ose ndihmese në punë hulumtuese edhe në formën online që i ofrohet secilit student pa dallim apo diskriminim.

Analiza SWOT për studentët:

A. Pikat e forta

- Interesimi i madh i kandidatëve për studime master në filozofi, në veçanti duhet theksuar interesimi i madh i kandidatëve nga fushat tjera.
- Orari fleksibil i ligjeratave për student të MA, shkak i punësimit apo obligimeve tjera relevante.
- Pjesëmarrja në konferencat vendore (Dita Botërore e Filozofisë), dhe debate të organizuara nga Departamenti i Filozofisë dhe Shoqata e Filozofëve të Kosovës.

B. Dobësitë

- Mungesa e njohurive të gjuhëve të huaja nga ana e studentëve
- Mungesa e fondeve për pjesëmarrje në aktivitete filozofike jashtë Kosovës.
- Mungesë e nivelit PhD të studimeve në filozofi për të diplomuarit që dëshirojnë të thellojnë njohuritë nga kjo fushë.

C. Mundësitë

- Pjesëmarrja në programme ndërkombëtare të mobilitetit për studentët (CEEPUS, ERASMUS+, universitete dhe shkollat verore etj.)
- Publikimi i punimeve në revistat vendore dhe ndërkombëtare shkencore, filozofike, letrare (Agora Philosophia, Symboli, Synthesis, etj.)
- Pjesëmarrja në konferencat ndërkombëtare të filozofisë.

D. Sfidat

- Punësimi i të diplomuarëve në Departamentin e Filozofisë shkak i politikave të gabuara dhe diskriminuese të MASHT në lidhje me lëndë dhe mësimdhënie të lëndëve të filozofisë.

Treguesi i performancës 5.1. Nëse është e nevojshme, përcaktohet një proces adekuat i përzgjedhjes si dhe rregulla të njohjes për kualifikimet e huaja në pajtim me Konventën e Njohjes së Lisbonës si dhe kualifikimet e fituara jashtë institucioneve të arsimit të lartë.

Çdo student që realizon mobilitet ndërkombëtar në universitete, institute kërkimore dhe qendra të ngjashme hulumtuese, i transferon notat dhe ECTS në përputhje me “Rregulloren, Nr: 2/111, 2017 për mobilitetet akademik të studentëve në Universitetin e Prishtinës”. I gjithë procesi i ekuivalentimit të notave dhe ECTS-ve realizohet me procedura të qarta nën udhëheqjen e Drejtuesit të Departamentit dhe të Koordinatorit për Zhvillim Akademik në Fakultetin Filozofik.

Treguesi i performancës 5.2. Janë krijuar sisteme për monitorimin dhe koordinimin e ngarkesës së punës së studentëve nëpër kurse. Ekzistojnë sisteme për monitorimin e progresit të nxënësve individual me ndihmë dhe/ose këshillim për ata që hasin vështirësi. Normat e përparimit në vit dhe progresin e programit monitorohen dhe analizohen për të identifikuar dhe ofruar ndihmë për çdo kategori studentësh që mund të kenë vështirësi.

Koordinimi dhe monitorimi i ngarkesës së punës së studentëve nëpër kurse sigurohet përmes procedurës së akreditimit të programit. Procesi implementohet me ndihmen e bartësit e lëndës ndërsa monitorohet nga përgjegjësi i programit dhe stafi menaxherial të Fakultetit.

Treguesi i performancës 5.3. Vlerësimi i testeve, detyrave dhe projekteve të nxënësve ndihmohet nga përdorimi i matricave ose mjeteve të tjera për të siguruar që gama e planifikuar e fushave të rezultateve të të nxënësve të studentëve janë adresuar. Janë marrë masa brenda institucionit për trajnimin e stafit mësimdhënës në teorinë dhe praktikën e vlerësimit të studentëve.

Stafi akademik është i trajnuar nga Qendra për përsosmëri në mësimdhënie pran Rektoratit të Universitetit të Prishtinës për zhvillimin e kurrikulës dhe syllabusit në përputhje me kërkesat dhe standardet për vlerësim të vazhdueshëm të studentëve, që nënkupton ndarjen e vlerësimit në disa komponente: diskutimet në klasë, prezentimet, esetë dhe provimi final.

Treguesi i performancës 5.4. Janë ofruar shërbime mbështetëse (p.sh. në lidhje me programin e studimit, këshillimin e nxënësve në rast të problemeve emocionale, financiare ose familjare, udhëzime për karrierë, çështje ndërkombëtare, këshilla ligjore etj.) si dhe lëndë të lidhura dhe udhëzime ndërdisiplinore janë dhënë.

N/A

Treguesi i performancës 5.5. Tekstet dhe materialet referuese janë të përditësuara dhe përfshijnë zhvillimet më të fundit në fushën e studimit. Tekstet dhe materialet e tjera të kërkuara janë në dispozicion në sasi të mjaftueshme para fillimit të orëve.

Përditësimi i syllabuseve bëhet në mënyrë individuale dhe në përputhje më trende të informacionit dhe literaturës. Syllabuset e përditësuesra janë në dispozicion studentëve përmes publikimit të tyre online në ueb faqe të Fakultetit Filozofik.

Treguesi i performancës 5.6. Fushat akademike ose profesionale për të cilat janë duke u përgatitur studentët monitorohen në baza të vazhdueshme me përshtatjet e nevojshme të bëra në program dhe në tekstin dhe materialet referuese për të siguruar relevancën dhe cilësinë e vazhdueshme.

Më rastin e ri-akreditimit departamentet propozojnë ndryshime programore të cilat duhet t'i përshtatën kërkesave të studentëve dhe zhvillimeve aktuale. Deri në 20% e përmbajtjes së programit rishikohet dhe mund propozohen kurse të reja.

1.5. Hulumtimi

Standardi 6.1. Programi i studimit ka përcaktuar objektivat kërkimore shkencore/të aplikuara (vetë ose si pjesë e një qendre kërkimore ose programi ndërdisiplinor), të cilat reflektohen edhe në planin e zhvillimit të kërkimit të institucionit; burimet e mjaftueshme financiare, logjistike dhe njerëzore janë alokuar për arritjen e objektivave të propozuara të hulumtimit.

Fakulteti Filozofik ka Strategjinë e Zhvillimit të Fakultetit 2018-2023 dhe Planin e veptimit për implementimin e Strategjisë në fjalë. Me këto dokumente strategjike janë të përcaktuara objektivat kërkimore dhe dinamika e realizimit të aktiviteteve në arritshmërinë e objektivave.

Në përputhje me Strategjinë dhe me nevojat e Programit MA në Filozofi Fakulteti Filozofik do të:

- Rrisë bashkëpunimin ndërkombëtar përmes projekteve hulumtuese, konferencave shkencore, seminareve, simpoziumeve me pjesëmarrjes të stafit akademik dhe studentët;
- Rrisë bashkëpunimin me institucionet vendore si institucione shtetërore, institute kërkimore– shkencore, institucione publike, organizatat joqeveritare, komunitete të ndryshme, etj.
- Zhvillojë më tutje Institutin për Shkoncat Sociale dhe Humanistike (ISSH);
- Investojë në abonime në databaza të revistave ndërkombëtare dhe librarive elektronike.
- Kushtojë rëndësi dhe do të rrisë kapacitetet për botimin e punës shkencore hulumtuese të stafit akademik dhe studentëve. Politikat e publikimit do të përqendrohen në aspektet e mëposhtme:

- Botimi i monografive, artikujve shkencorë, teksteve universitare, kumtesave e konferencave shkencore, ligjëratave të autorizuara, doracakëve dhe katalogjeve;
- Botuesit ndërkombëtarë dhe vendorë duhet të jenë kredibilë;
- Fakulteti Filozofik do të përkrahë teknikisht dhe financiarisht aktivitetet hulumtuese dhe publikimet e stafit akademik;
- Botimi dhe indeksimi i revistave të Fakultetit Filozofik.

Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit 2018-2023 dhe Plani i veptimit për implementimin e Strategjisë në fjalë kanë planin buxhetor të implementimit të tyre.

Standardi 6.2. Pritjet për përfshirjen e stafit mësimdhënës në veprimtaritë kërkimore dhe akademike janë specifikuar qartë dhe performanca në lidhje me këto pritje është konsideruar në kriteret e vlerësimit dhe promovimit të stafit.

Universiteti i Prishtinës ka të rregulluar çështjen e promovimit të stafit mësimdhënës, përmes kërkesë obligative për hulumtime kërkimore shkencore dhe botimin e tyre në revistat me kredibilitet ndërkombëtar, përcaktuar me Statutin e UP –së, nenet 164,165,166,167 ,168 dhe 175,176, 177, si dhe Rekomandimit të Senatit të UP-së nr.1/344 dt. 22/06/2016, ku përcaktohen platformat për botim të punimeve nga stafi akademik i UP-së duke preferuar platformën Scopus si me te vlerësuarën.

Si rezultat i kësaj stafi mësimdhënës është i obliguar që të angazhohet në veprimtarinë kërkimore dhe akademike dhe se performanca e tyre në këtë drejtim është kriter bazë I promovimit të tyre në gradat akademike. Organizimi dhe pjesëmarrja në simpoziume, konferenca, si dhe botimi rezultateve të hulumtimeve kërkimore shkencore është parakusht për avancim i çdo mësimdhënësi.

Standardi 6.3. Janë krijuar politika të qarta për përcaktimin e asaj që njihet si hulumtim, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe normat e vendosura në fushën e studimit të programit.
Standardi

Universiteti i Prishtinës ka të rregulluar çështjen e vlerësimit të kontributit profesional e shkencor të mësimdhënësve. Në veçanti është e rregulluar çështja e poentimit të publikimeve dhe botimeve në revistat lokale dhe ato ndërkombëtare me impakt faktor, mbështetur ne Stautin e UP-së , Udhëzimin e MASHT-it dhe Rekomandimin e Senatit të potencuar më lartë.

6.4. Stafi akademik ka një histori të provuar të rezultateve të hulumtimit në të njëjtat tema si aktiviteti i tyre mësimor.

Mësimdhënësit e angazhuar në këtë program të studimeve kryesisht janë profesor të cilët kanë një përvojë të angazhimit akademik. Po kështu stafi mësimdhënës kanë hulumtime në fushën e filozofisë.

Në vazhdim ju paraqesim një pasqyrë të publikimeve shkencore të stafit akademik të Departamentit të Filozofisë për 5 vitet e fundit:

		Llojet e publikimeve: 1.Konferenca 2.Kongresi 3.Seminari 4.Workshop 5.Revista 6.Të tjera				
Autori/ët	Titulli i punimit	Data e publikimit	Emri i revistës apo botuesit	Lloji*	Vegëza (Linku)	
Astrit Salihu	“Heidegger ili mišljenje arhitekture kroz bitak”	2018	Filozofska Istraživanja, 151(38/2018), 637-650.	Artikull Shkencor.	https://hrcak.srce.hr/215038	
Astrit Salihu	“Odyssey of Dwelling: Challenge of Modern Architecture”	2018	Synthesis Philosophica , 66(2/2018), 527-538	Artikull Shkencor.	---	
Astrit Salihu	“Antipoetika e Hapësirës: Mbi Pushtetin dhe hapësirën te Michel Foucault”	2018	Agora Philosophia , Nr.1, KDU: 321:14, 7-54	Artikull Shkencor.	---	
Astrit Salihu	“Bachelard dhe eksplorimi i poetikës së hapësirës”	2018	Symbol , 2018, Nr 13, ISSN 2415-2749 (Online), ISSN 2310-9998 (Print)	Artikull Shkencor.	---	

Astrit Salihu	“Drejt Një Arkitekture Postmoderne: Charles Jencks, ose kodi i dyfishtë në arkitekturë”	2018	Symbol, 2015, Nr. 4, ISSN 2310-9998, 48-69	Artikull Shkencor.	---
Astrit Salihu	Lexim Filozofik i Arkitekturës	2018	SHFK, Prishtinë	Libër	---
Astrit Salihu	<i>SOFISTIKA I POSTMODERNA - Sofističke reminiscencije</i>	2019	Mediterranski korijeni filozofije : Čovjek je mjera svih stvari – Protagora, uz 2500. obljetnicu rođenja, Split	Prezantim në konferencë ndërkombëtare	---
Hasnije Ilazi	“Pojam čovjeka kao socijalno konstituiranog sebstva u Taylorovoj teoriji morala” (“The Notion of Human Being as a Socially Constructed Self in Taylor`s Theory of Morality”),	2020	Filozofska istraživanja, 158, Vol.40 No 2, 2020 str 297-311, Zagreb	Artikull Shkencor.	https://hrcak.srce.hr/index.php?show=toc&id_broj=19500
Hasnije Ilazi	Njeriu shumëdimensi	2019	Pema, Prishtinë	Libër	---

	onal (dhe përsiatje tjera mbi identitetin modern)				
Hasnije Ilazi	“Drei Fragen der kosmopolitischen Demokratie: Modernität, Anerkennung, Säkularismus”	2018	Në: Kosmopolitische Demokratie, Nomos, Baden-Baden	Kapitull libri	---
Hasnije Ilazi	“Afirmacija ljudskog u simboličkim formama: Cassirer o jeziku i znanosti” (“The Affirmation of Human by Symbolic Forms: Cassirer on Language and Science”)	2018	Filozofska istraživanja, nr. 150, vëll.2, fq. 231-454,	Artikull Shkencor.	https://hrcak.srce.hr/index.php?shoë=toc&id_broj=16680
Hasnije Ilazi	“Three issues on Cosmopolitan Democracy: Modernity, Recognition, Secularism”	2016	Synthesis Philosophica 61 (1/16), vol.31, pp 1-226,	Artikull Shkencor.	https://hrcak.srce.hr/file/265301
Hasnije Ilazi	“Liria si moral i vetës” (Hannah Arendt mbi të keqen)	2016	Në: Liria dhe politika: Hannah Arendt 40 vjet pas, Fakulteti i	Kapitull libri	---

			Shkencave Sociale, Tiranë		
Hasnije Ilazi	“Što znači biti heretik danas?” (“ <i>What Does It Mean to Be a Heretic Today? The Question of Humanity’s Perspective in the Contemporary Society</i> ”)	2015	Filozofska istrazivanja, Vol. 35 No. 2, 277-287	Artikull Shkencor.	https://hrcak.srce.hr/index.php?show=clanak&id_clanak_jezik=234153
Hasnije Ilazi	“Afirmimi i njerëzores përmes formave simbolike: animal symbolicum si gjuhë dhe shkencë”	2019	Konferencë ndërkombëtare;	Prezantim në konferencë ndërkombëtare	---
Hasnije Ilazi	Tema: “Demokracia si epokë sekulare”	2018	Konferencë ndërkombëtare; <i>Radikalizmi :perspektiva filozofike</i> Universiteti i Prishtinës, Departamenti i Filozofisë dhe Shoqata e Filozofëve të Kosovës, Prishtinë,	Prezantim në konferencë ndërkombëtare	---

Hasnije Ilazi	Tema: “ Pojam čovjeka kao socijalno konstituiranog sebstva u Taylorovoj teoriji morala / The Concept of Man as a Socially Constituted Self in Taylor’s Moral Theory”	2018	2018, International Symposium “ <i>Days of Frane Petrič, Topic: The Human Nature</i> ” Croatian Philosophical Association Cres, Croatia, presentation	Prezantim në konferencë ndërkombëtare	---
Hasnije Ilazi	Tema: “Secularism and religion in modern global society (the issue of identity)”	2015	International Conference, <i>Philosophy and Democracy</i> , Croatian Philosophical Association, Dubrovnik, Croatia,	Prezantim në konferencë ndërkombëtare	---
Hasnije Ilazi	Tema: “Liria si moral i vetës”	2015	Dita botërore e Filozofisë, Konferencë ndërkombëtare, <i>Liria dhe politika: 40 vjet pas Hannah Arendt</i> , Universiteti i Tiranës dhe Universiteti i Prishtinës,	Prezantim në konferencë ndërkombëtare	---

			Tiranë dhe Prishtinë,		
Hasnije Ilazi	Tema: “Individual and collective identity: The interplay between the “self” and the “other” “	2014	International Conference on Identity Studies, Centre for Research in Social Sciences and Humanities (Zagreb), Vienna, Austria,	Prezantim në konferencë ndërkombëtare	---
Kristë Shtufi	Gottlob Frege über Sinn und Bedeutung von Namen und Sätzen. Eine Exegese Geschichte	2017	Publikimet Universitare Online të Univ. Graz.	Publikim online i diss.	http://unipub.uni-graz.at/obvugrh/s/download/pdf/2307854?originalFilename=true
Kristë Shtufi	“On The Dialectical Maxim Of Critical Rationalism”	2018	<i>Mütefekkir.</i> vëll: 5, (9), fq. 33-46	Artikull Shkencor.	https://dergipark.org.tr/download/article-file/502986
Kristë Shtufi (bashkë me Blerim Latifin)	“O strujama suvremenoga islama, svetom ratu i čitanju Kurana”	2019	Obnovljeni Život, vëll. 74(3), 379–398	Artikull Shkencor.	https://hrcak.srce.hr/index.php?show=clanak&id_clanak_jezik=323825
Kristë Shtufi	Tema: “Zoti i filozofëve dhe Zoti i besimit: cili është më radikal?”	2018	Konferencë ndërkombëtare; <i>Radikalizmi :perspektiva filozofike</i> Universiteti i Prishtinës, Departamenti i Filozofisë dhe Shoqata e	Prezantim në konferencë ndërkombëtare	---

			Filozofëve te Kosovës, Prishtinë,		
Blerim Latifi	Foucault mbi dijet humane	2014	Symbol, Nr.1, 101-114	Artikull Shkencor.	---
Blerim Latifi	“Liria dhe logjika: interpretimi i Beiser i dialektikës hegeliane të clirimit”	2015	Symbol, Nr.3	Artikull Shkencor.	---
Blerim Latifi	O šteti i koristi marksizma za povijest	2013	FILOZOFSKA ISTRAŽIVANJ A 132 God. 33 (2013) Sv. 4 (739–751)	Artikull Shkencor.	https://hrcak.srce.hr/index.php?show=clanak&id_clanak_jezik=175312
Blerim Latifi	Metafizika e Emancipimit, Ideja e emancipimit të njeriut në filozofinë perëndimore	2016	Akademia e Arteve dhe Shkencave të Kosovës/ Prishtinë	Libër	---
Blerim Latifi	Biseda mbi filozofinë bashkëkohore	2017	UET Press, Tiranë	Libër	---
Blerim Latifi (bashkë me Kristë Shtufin)	“O strujama suvremenoga islama, svetom ratu i čitanju Kurana”	2019	Obnovljeni Život, vëll. 74(3), 379–398	Artikull Shkencor.	https://hrcak.srce.hr/index.php?show=clanak&id_clanak_jezik=323825
Anton Vukpalaj	Acquittals at the International Criminal Tribunal for the forms	2018	Studies on Transition States and Societies, Vol 10, No 1 (2018)	Artikull Shkencor.	---

	Yugoslavia (ICTY) in 2012-2013: the domestic implications				
Anton Vukpalaj	Bajraku institucion politiko-administrativ osman në ambientin e Alpeve shqiptare	2015	Studime Shoqërore, Nr. 2	Artikull Shkencor.	---
Ardian Gola Gola, Ardian dhe Selaci, Gëzim	“Socio-political and Religious Dynamics in Kosovo from the Post-Secularist Perspective”	2017	<i>Politička Misao, Croatian Political Science Review</i> , 54(4)	Artikull Shkencor.	---
Ardian Gola	“Drejt një konceptimi postsekularist të shoqërisë kosovare”.	2015	<i>Seminari XXXIV ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare.</i> Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i Prishtinës: Prishtinë. Libri 2. – 638 vjuesë.	Artikull Shkencor.	---
Ardian Gola	“Format patologjike të ndarjes	2015	<i>Hikmet.</i> Nr. 11. Prishtinë: Instituti për	Artikull Shkencor.	---

	shoqërore të punës sipas Durkheim-it”.		shkencat humane “Ibn Sina”.		
Ardian Gola	“Dikotomia epistemologjike shkencë – filozofi”.	2014	<i>Studime Shoqërore</i> . Nr. 1. Prishtinë: AShAK.	Artikull Shkencor.	---
Valon Leci	“The doctrine of Liberalism for state protection of workers’ right in the Republic of Kosovo”	2018	Balkan Journal of Interdisciplinary Research Vol. 3, No. 3	Artikull Shkencor.	
Valon Leci	“A philosophical approach on administrative procedure”	2018	European Journal of Economics, Law and Social Sciences, Vol. 2, January 2018	Artikull Shkencor.	
Valon Leci	“A duhet që normat pozitive të përkojnë me ato morale?”	2015	REVISTË STUDIMORE – SHKENCORE INTERDISIPLINARE. Qendra Kërkimore Zhvillimore – PEJA Buletini Shkencor Nr. 3	Artikull Shkencor.	
Valon Leci	“Presocratics as the first	2017	ITCEA 2017 THE 6-TH	Konferencë shkencore	

	carriers of theories on the right and freedom”		INTERNATIONAL MULTIDISCIPLINARY CONFERENCE on NEW ADVANCED METHODOLOGIES AND TECHNIQUES in SCIENTIFIC RESEARCH CONFERENCE PROCEEDING BOOK Volume 2	ndërkombëtare	
Valon Leci	“On norms for norms in Republic of Kosovo”	2017	FIRST INTERNATIONAL CONFERENCE ON: “SOCIAL AND NATURAL SCIENCES – GLOBAL CHALLENGE 2017” (ICSNS I-2017)	Konferencë shkencore ndërkombëtare	
Valon Leci	“ Shqyrtim i shkurtër i variacioneve të egalitarizmit përmes disa pikëpamjeve filozofike”	2018	SIXTH INTERNATIONAL CONFERENCE ON: “EDUCATION AND SOCIAL SCIENCES- CHALLENGES TOWARDS THE FUTURE”	Konferencë shkencore ndërkombëtare	

			2018 (ICES VI-2018)		
Valon Leci	“ Mbi parimet morale të hartimit të legjislacionit në Republikën e Kosovës”	2015	Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë DIDAKTIKA E SHKENCAVE KORÇË, 2015	Konferencë shkencore ndërkombëtare	

Standardi 6.5. Stafit akademik dhe hulumtues publikojnë punën e tyre në revista specialiteti ose shtëpi botuese, produktet shkencore/aplikative/artistike prezantohen në konferenca, seanca, simpoziume, seminare etj. Kontratat, ekspertiza, konsultimet, konventat etj. u ofrohen partnerëve brenda vendit dhe/ose jashtë vendit.

Pjesa më e madhe e publikimeve të stafit akademik janë të botuara në revistat ndërkombëtare (shih listën e më lartë!). Materiale të ndryshme hulumtuese siç janë monografi, librat mësimor, apo prezantimet e ndryshme kërkimore në konferenca, simpoziume apo tryeza të ndryshme shkencore jenë të botuara edhe në Kosovë.

Sipas nevojës dhe rasteve Departamenti i Filozofisë ofron edhe ekspertizë apo përkrahje tjetër të nevojshme për entitete brenda vendit nga fusha të caktuara për të cilat është kompetent.

Të dhënat e plota të karrierës së secilit profesor gjenden në CV-të e tyre, të cilat janë të publikuara ne uebfaqen e Fakultetit Filozofik.

Standardi 6.6. Hulumtimi vërtetohet nëpërmjet: botimeve kërkimore shkencore dhe aplikative, produkteve artistike, transferimit teknologjik përmes qendrave të konsulencës, parqeve shkencore dhe strukturave të tjera për validim.

Hulumtimet kryesisht vërtetohen përmes botimit të tyre ne revistat kërkimore shkencore në vend dhe në ato ndërkombëtare. Organizmi i konferencave shkencore, seminareve dhe konferencave paraqesin një mënyrë të promovimit të hulumtimeve shkencore kërkimore.

Standardi 6.7. Çdo anëtar i stafit akademik dhe studiues ka prodhuar së paku një mesatare prej një botimi kërkimi shkencor/aplikuar ose rezultat artistik/produkt në vit për tre vitet e fundit.

Është standard i avancimit dhe promovimit akademik botimi i së paku një hulumtimi kërkimor shkencor brenda një viti në një reviste ndërkombëtare me impakt factor. Lista e punimeve e prezantuar më lartë tregon aktivitetin botues të stafit edhe gjatë tri viteve të fundit.

Standardi 6.8. Stafit akademik dhe hulumtues publikon nën emrin e institucionit në Kosovë, ku ata janë të lidhur si staf me kohë të plotë.

Stafi akademik kryesisht publikon hulumtimet e tyre në emrin e tyre duke adresuar njësinë akademike ku është i angazhuar si mësimitdhënës në kuadër të Universitetit të Prishtinës.

Standardi 6.9. Personeli akademik inkurajohet të përfshijë në informacionin e tyre të mësimitdhënies në lidhje me hulumtimet e tyre dhe aktivitetet shkencore që janë relevante për kurset që ata mësojnë, së bashku me zhvillimet e tjera të rëndësishme kërkimore në terren.

Punimet e botuara të stafit janë rezultat i hulumtimit të tyre në fushën e interesimit e që është njëkohësisht edhe fusha për të cilën mësimitdhënësi është i/e angazhuar në mësimitdhënie. Tekste të botuara janë shpesh pjesë i syllabuseve të cilat i ofrohen studentëve.

Standardi 6.10. Janë krijuar politika për pronësinë e pronësisë intelektuale dhe procedura të qarta të përcaktuara për komercializimin e ideve të zhvilluara nga stafi dhe studentët.

Në Kosovë ekziston ligji për mbrojtjen e pronës intelektuale. Universiteti ka të përcaktuara qartë rregullat lidhur me pronësi e krijimit shkencor dhe ka përcaktuar edhe masa ndëshkuese për keqpërdorimin e saj.

Standardi 6.10. Studentët janë të angazhuar në projekte kërkimore dhe aktivitete të tjera.

Duke pasë parasysh natyrën teorike të studimit të filozofisë studentët janë kryesisht angazhuar që ta kryejnë punën hulumtuese përmes literaturës në punime seminarike, prezantime dhe punimin e diplomës. Mirëpo student të masterit në filozofi publikojnë edhe në revistë të Departamentit “Agora Philosophia”, sikur dhe marrin pjesë në konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare. Për më tepër në kuadër të revistës “Agora Philosophia” ekziston Bordi i Juniorëve i cili është i angazhuar në aktivitete të botuese të studentëve.

Analiza SWOT për hulumtim:

A. Pikat e forta

- Ndërkombëtarizimi i departamentit (përfshirja e Departamentit në programet e bashkimit evropian dhe më gjerë si CEEPUS, ERASMUS+, etj.) fuqizon komponentën hulumtuese të stafit dhe studentëve
- Organizimi dhe pjesëmarrja në konferencat vendore dhe ndërkombëtare (Dita botërore e filozofisë shënohet nga Departamenti i Filozofisë në bashkëveprim me Shoqatën e Filzofëve të Kosovës çdo vit për 10 vite me radhë deri tani dhe në vazhdimësi)
- Publikimet e stafit dhe e studentëve master nëpër revista ekzistuese shkencore në vend dhe jashtë vendit (Agora Philosophia, Njohja, Synthesis, Filozofska Istrazivanja)

B. Dobësitë

- Vështirësitë në plotësimin e kriterëve për ndërkombëtarizimin e revista filozofike albanofone si Revistat “Agora philosophia”, “Njohja” (Vendosja e tyre si në platformat SCOPUS, Web of Science etj.)
- Mungesë e fondeve vetanake të Departamentit për përkraje të stafit dhe studentëve për pjesëmarrje në konferenca dhe botimin e artikujëve dhe librave.

C. Mundësitë

- Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar
- Publikimet e stafit dhe e studentëve master nëpër revista ekzistuese shkencore në vend dhe jashtë vendit
- Zhvillimi i projekteve hulumtuese përmes Institutit për Studime Sociale dhe Humanistike

D. Sfidat

- Mungesa e politikave të mirëfillta për avancimin profesional të stafit akademik bazuar në pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare dhe publikime nëpër revista ndërkombëtare

- Mungesë e politikave të mirëfillta për mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrje të stafit dhe studentëve në konferencat nderkombëtare
- Mungesë e buxhetit për përkrahje financiare të botimeve të librave me llogon e UP (përkrahja e UP-së për botimin e librave nga ana e Universitetit konsiston vetëm në dhëniën e lejes për përdorimin e llogos, ndërsa botimet bëhen me vetëfinansim të stafit)
- Dinamika e ngadalësuar të procedurave përmes të cilëve do duhej të njihet puna hulumtuese të stafit nga ana e rektoratit (vonësa në shpalljen e konkurseve për pranimin apo avancimin e stafit, mosnjohja adekuate e konferencave dhe punimeve nga konferencat shkencore, etj.)
- Decentralizimi i UP nga aspekti i vendimmarrjes dhe i buxhetit, mugesë e të cilit pamundëson gjenerimin e fondeve për Departamentin nga ekspertiza e cila ofrohet për palët e interesuara.

Departamenti i Filozofisë është pjesë e rrjeteve dhe programeve ndërkombëtare të fushës së filozofisë (CEEPUS, Erasmus+, etj.). Stafi i departamentit ka pasur përkrahje të vazhdueshme dhe pa rezervë nga menxhmenti i Fakultetit Filozofik dhe të UP-së për iniciimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe zhvillimin e bashkëpunimit ndërkombëtarë hulumtues.

Treguesi i performancës 6.2. Programi i studimit organizon në mënyrë periodike sesione shkencore, simpoziume, konferenca, tryeza të rrumbullakëta me përfshirjen e stafit mësimdhënës, hulumtues, studentë dhe të diplomuar, ndërsa procedurat publikohen në ISBN, në raportet shkencore të ISSN-së ose në revista të dedikuara për atë aktivitet të caktuar.

Departamenti i Filozofisë organizon konferenca ku marrin pjesë profesorët, studentë dhe studiues të tjerë nga vendi dhe bota e jashtme. Departamenti poashtu organizon tryeza të rrumbullakëta dhe debate ku përfshihen profesorët vizitorë, hulumtuesit dhe personalitetet nga jeta publike. Deri më tani hulumtime dhe prezantime në konferenca dhe debate janë botuar në revista ndërkombëtare të indeksuara (SCOPUS, WEB of Science etj.), por poashtu edhe në revista të Fakultetit Filozofik: Agora Philosophia, Njohja, Buletin. Stafi i Departamentit të Filozofisë së bashku më Shoqatën e Filozofëve të Kosovës dhe në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Filozofisë në Zagreb është duke punuar intenzivisht në përmbushjen e kriterëve për indeksim ndërkombëtar të revistës filozofike Agora Philosophia.

Treguesi i performancës 6.3. Mbështetje është ofruar për stafin e vogël mësimor në zhvillimin e programeve të tyre kërkimore përmes mekanizmave të tilla si mentorimi nga kolegët e senior, përfshirja në ekipet e projektit, ndihma në zhvillimin e propozimeve të kërkimit dhe financimi.

Stafi i ri mësimor përkrahet në zhvillimin e propozimeve për programe kërkimore zhvillimore dhe publikime nga stafi senior të Departamentit të Filozofisë dhe menaxhmenti i Fakultetit. Stafi senior mësimor është pjesë e mentorimit të projekteve kërkimore të stafit junior, dhe ura lidhëse me institucione më kredibile shkencore në rajon, Europë dhe më gjërë. Poashtu, stafi senior

ofron ndihmen profesionale ne formë të recenzeve për botime të stafit junior. Ashtu siç është përmendur më lartë, në kuadër të revistës Agora Philosophia ekziston Bordi Junior i cili mundëson publikime për stafin junior dhe studentët e masterit, nën mbikqyrjen e stafit senior.

Treguesi i performancës 6.4. Janë prezantuar strategji për identifikimin dhe kapitalizimin e ekspertizës së stafit mësimdhënës dhe studentëve në ofrimin e shërbimeve kërkimore dhe zhvillimore për komunitetin.

Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit Filozofik 2018-2023 është dokument bazë me të cilën sigurohen objektivat dhe arritja e tyre në aspektin e hulumtimit. Rekrutimi i stafit të ri akademik, asistentëve dhe mësimdhënësve është duke u bërë sipas planit të implementimit. Për fat të keq kjo dinamikë shpesh pengohet shkaku i ngadalësimit të proceseve (vonësa në shpalljen e konkurseve për pranimin apo avancimin e stafit, mosnjohja e konferencave dhe punimeve nga konferencat shkencore, etj.) përmes të cilëve do duhej të njihet puna hulumtuese të stafit nga ana e rektoratit. Sidoqoftë, vazhdon zhvillimi i vazhdueshëm i stafit përmes ofrimit të trajnimeve, mobilitetit akademik, projekteve dhe formave tjera të promovimit të hulumtimit.

Treguesi i performancës 6.5. Institucioni është duke monitoruar dhe mbështetur kontributin e stafit për tërheqjen e burimeve financiare përmes projekteve hulumtuese/aplikative/artistike dhe produkteve. Kapaciteti i stafit për të gjeneruar këto kthime financiare konsiderohet në sistemin e shqyrtimit individual të performancës.

Fakulteti Filozofik përkrahë dhe monitoron kontributin e stafit për zhvillimin e projekteve hulumtuese dhe të tilla që gjenerojnë mjete financiare. Instituti për Studime Sociale dhe Humanistike ka qenë mundësi e vazhdueshme për implementimin e projekteve nga Departamenti i Filozofisë. Kjo për faktin se Departamenti nuk ka vijën e veçantë buxhetore përmes të cilës do të gjeneroheshin fonde nga ekspertiza e ofruar. Prandaj është i domosdoshëm decentralizimi buxhetor i UP-së.

Treguesi i performancës 6.6. Bashkëpunimi me industrinë lokale dhe me agjencitë e tjera kërkimore inkurajohet. Kur është e përshtatshme, këto forma të bashkëpunimit përfshijnë projekte të përbashkëta kërkimore, përdorim të përbashkët të pajisjeve dhe strategjive bashkëpunuese për zhvillim.

Departamenti i Filozofisë ka rritë bashkëpunimin me institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare në aspektin e hulumtimit. Poashtu, Departamenti bashkëpunon edhe me institucione shtetërore, institucione publike, organizatat joqeveritare, dhe komunitetin në përgjithësi përmes projekteve të përbashkëta hulumtuese, konferencave shkencore, seminareve, simpoziumeve, me pjesëmarrje të stafit akademik, studentëve, ekspertëve të fushave etj.

2.7 Infrastruktura dhe burimet:

Standardi 7.1. Zbatimi adekuat afatgjatë i programit studimor sigurohet në terma sasiorë për sa i përket ambienteve, burimeve njerëzore dhe pajisjeve. Në të njëjtën kohë, garantohet që aspektet cilësore të merren parasysh gjithashtu.

Programi zbatohet vetëm gjatë periudhës, për të cilën është i akredituar nga AKA. Në planin infrastrukturor, për realizimin e këtij programi është në dispozicion hapësirë më se e mjaftueshme në Fakultetin Filozofik. Kjo hapësirë është përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve pedagogjike dhe kërkimore dhe është e prezantuar përgjithësisht në pjesën e RVV të institucionit.

Standardi 7.2. Ekziston një plan financiar në nivelin e programit të studimit që do të demonstroi qëndrueshmërinë e programit të studimit minimalisht për tre vitet e ardhshme.

Departamenti nuk ka kompetenca vendimmarrëse për planifikim financiar. Planifikimin financiar e bën Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës me kërkesën e Fakultetit Filozofik, ku Departamenti bën *propozime* lidhur me aktivitetet.

Standardi 7.3. Institucioni i arsimit të lartë duhet të demonstrojë me dokumente adekuate (veprat e pronës, kontratat e qirasë, inventarët, faturat etj.) që, për programin e studimit të dorëzuar për vlerësim, ka të paktën tre vitet e ardhshme: a) hapësira në pronësi ose me qira të përshtatshme për procesin arsimor; b) laboratorë në pronësi ose me qira, me pajisje adekuate për të gjitha disiplinat e detyrueshme brenda kurrikulit, kudo që programi mësimor analitik përfshin aktivitete të tilla; c) softuer adekuat për disiplinat e studimit të përfshira në kurrikulë, me licencë përdorimi; d) biblioteka e pajisur me sallat e leximit, dhomat e punës në grup dhe rezervat e veta të librave sipas disiplinave të përfshira në kurrikulat.

Departamenti i Filozofisë është i vendosur brenda Fakultetit Filozofik. Këto hapësira janë pronë e Universitetit. Dokumentimi i pronësisë është kompetencë e Rektoratit. Departamenti nuk posedon me dokumentacione të tilla administrative. Dokumentacionin për Fakultetin e posedon Koordinatorin për Zhvillim Akademik përkatësisht Dekanati.

Standardi 7.4. Numri i ulëseve në sallat e ligjëratave, dhomat e seminarit dhe laboratorët duhet të lidhet me madhësinë e grupeve të studimit (seri, grupe, nëngrupe); aktivitetet aplikative për

disiplinat e specializuara të përfshira në kurrikula janë kryer në laboratorë të pajisur me pajisje të IT.

Departamenti i Filozofisë ka në dispozicion

- 1) Një amfiteatër me kapacitet prej rreth 100 studentëve (Amfiteatri bojëkafe 101).
- 2) Një sallë me kapacitet prej rreth 70 studentëve (salla 103).
- 3) Një sallë me kapacitet prej 40-60 studentëve, të cilën e ndanë me dy Departamente tjera (salla 102).

Këto janë sallat, në të cilat organizohet procesi mësimor. Megjithatë, për shkak se Fakulteti Filozofik disponon me një hapësirë komode prej gjithsej 1664 m² salla veç për mësim, Departamenti mund t'i shfrytëzojë edhe sallat tjera në marrëveshje me departamentet tjera sipas nevojës. Të gjitha sallat janë të pajisura me projektorë dhe mjetet tjera konkretizuese, si tabela muri, tabela të vogla etj. Për ngjarje shkencore (konferenca, seminare, tryeza, simpoziume) Departamenti ka në dispozicion edhe *sallën e konferencave*(salla 014) në katin përdhes, të sapo rinovuar dhe të pajisur me të gjitha pajisjet përcjellëse, të cilin e përdorin të gjitha departamentet e Fakultetit për qëllime të tilla.

I tërë stafi është i pajisur me zyre (6 zyra individuale të profesorëve dhe 1 zyrë të përbashkët të bashkëpunëtorëve të jashtëm), tavolinë pune, kompjuterë me të gjitha pajisjet përcjellëse si dhe në tërësi me të gjitha pjesët përbërëse të inventarit të nevojshëm për funksionimin e një zyre. Për këtë ekziston lista e inventarit të Fakultetit Filozofik, të cilën e posedon Zyrtarja për Çështje Materiale dhe Dekanati.

Standardi 7.5. Bibliotekat e institucioneve të arsimit duhet të sigurojnë, për secilin nga programet studimore:

a) një numër vendesh në dhomat e leximit që i përgjigjen të paktën 10% të numrit të përgjithshëm të studentëve në programin e studimit;

Salla e leximit në Fakultet posedon dhe përmbush kriterin e kërkuar, sepse ka numër të mjaftueshëm për të akomoduar më shumë se 10% të numrit të përgjithshëm të studentëve në programin e studimit. Kjo sallë ka gjithsej 78 vende leximi. Po ashtu vende për lexim ka edhe në bibliotekën e Fakultetit, në Bibliotekën Kombëtare, Bibliotekat e Qytetit etj..

b) një numër vendesh në dhomat e punës në grup që korrespondojnë me të paktën 10% të numrit të përgjithshëm të studentëve në programin e studimit;

Departamenti nuk posedon dhoma të punës për studenta.

c) rezervat e tyre të librave nga literatura e specialiteteve Shqiptare dhe të huaja, të mjaftueshme për të mbuluar disiplinat brenda kurrikulave, nga të cilat së paku 50% duhet të përfaqësojnë tituj librash ose kurse specialiteti të publicistëve të njohur, nga 10 vitet e fundit;

Biblioteka e Fakultetit furnizohet vazhdimisht me literaturë të re, por i përmbush vetëm pjesërisht nevojat e programit (ka literaturën më të re kryesisht në gjuhën shqipe). Furnizimi me libra i bibliotekës varet prej ndarjeve buxhetore në nivel qendror. Duke qene se në dhjetë vitet e fundit fondet librare janë pasuruar më tituj të ri të autorëve shqiptarë por edhe më tituj të përkthyer nga autorët e huaj mund të konstatojmë se një pjesë relativisht e mirë e kurrikulës së programit të studimit mbulohet me literaturë e cila ndodhët në bibliotekën e Fakultetit Filozofik. Me një fond literature në gjuhën angleze disponojnë profesorët dhe atë e ndajnë me studenta. Ky fond i literatures është siguruar kryesisht nga donacioni i Ambasadës Amerikane në Prishtinë, duke u bazuar në syllabuset e profesorëve.

d) Një rezervë librash në librarinë e tyre me një numër të mjaftueshëm të librave që përmbushin nevojat e të gjithë studentëve në ciklin dhe vitin e studimeve për të cilën sigurohet disiplina përkatëse;

Aktualisht nuk ka një vend të rezervuar si aparat semestral të ndarë nga biblioteka e përgjithshme. E tërë literatura që ka departamenti gjendet në bibliotekën e Fakultetit dhe te profesorët përkatës të lëndëve ku përkon literatura gjegjëse.

e) Një numër të mjaftueshëm të përshkrimeve për publikimet shqiptare, atyre të huaja dhe atyre periodike, sipas misionit të deklaruar. Biblioteka ka katalog të digjitalizuar i cili përmaban përshkrimin e nevojshem të literaturës në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.

Biblioteka është në planifikim të digjitalizimit. Biblioteka Kombëtare është digjitalizuar.

Standardi 7.6. Infrastruktura dhe objektet e dedikuara për zbatimin e programit përshtaten me nxënësit me nevoja të veçanta.

Infrastruktura dhe objektet iu përgjigjet pjesërisht kërkesave për zbatimin e programit për studentët më nevoja të veçanta, që do të thotë se iu përgjigjet vetëm personave me nevoja të veçanta që kanë të bëjnë me dëmtime në gjymtyrë. Tre katet e objektit janë të arritshme me ashensor. Kati përdhes dhe hyrja kryesore e objektit është e qasshme për të gjitha pajisjet, të cilat përdoren nga personat më nevoja të veçanta. Ndërsa nyjet sanitare në katin përdhes janë të pajisura më toalete për persona më nevoja të veçanta. Për persona me nevoja të veçanta të llojeve tjera (të verbërit, shurdhmemcët, etj.) nuk ekziston infrastruktura adekuate.

2.7.1 Analiza SWOT për infrastrukturën dhe burimet

A. Pikat e forta

- Infrastruktura në dispozicion për realizimin e këtij programi është e përshtatshme, këtë e ka treguar edhe programi aktual me të njëjtin fond të orëve;
- Hapësira dhe mënyra e organizimit të saj krijon komoditet infrastrukturor që e lehtëson realizimin e programit;
- Inventarizimi i hapësirave, sallave të mësimi, sallave të leximit, bibliotekave, kabineteve, zyrave të administratës dhe korridoreve;
- Pajisjet teknologjike, projektorë etj. janë të shpërndara në çdo hapësirë sipas nevojës.

B. Dobësitë

- Biblioteka e Fakultetit nuk është e lidhur më ndonjë rrjet rajonal apo evropian të bibliotekave dhe për pasojë studentët e këtij programi nuk e kanë mundësinë e shfrytëzimit të literaturës online.
- Biblioteka e Universitetit nuk ka mundësi të huazimit të librave nga Universitete rajonale apo botërore.
- Mungesa e lidhjes së internetit në krejt objektin e fakultetit, gjë që do ta lehtësonte procesin e konkretizimit gjatë mësimdhënies.
- Mungesa e kompjuterëve statik nëpër salla e amfiteatra të mësimdhënies.
- Qasja e kufizuar në platforma elektronike për të gjithë profesorët dhe studentët për shfrytëzimin e literaturës përkatëse.
- Monitorë informues në hyrje të fakultetit janë jofunksional.
- Mungesa e pajisjeve për zërim dhe përkthim.

C. Mundësitë

- Rritja e investimit në pasurimin e bibliotekës me tituj bashkëkohorë të librave, në gjuhën shqipe e gjuhë të huaja.
- Sigurimi i qasjes në revista shkencore përmes platformave elektronike.
- Rritja e investimit në avancimin e infrastrukturës moderne.
- Pajisja me kompjuterë nëpër salla.

D. Sfidat

- Përballimi buxhetor i kërkesave gjithnjë e në rritje përkitazi me avancimin e infrastrukturës, pasurimin e bibliotekës me tituj të rinj të librave (nga gjuhët e huaja), zgjerimin e qasjes në platforma elektronike ndërkombëtarisht të njohura të revistave shkencore, blerjen e kompjuterëve etj.

Treguesi i performancës 7.1. Janë hartuar plane formale për ofrimin dhe përmirësimin e infrastrukturës dhe burimeve, dhe zbatimi dhe efektiviteti i këtyre planeve monitorohet në baza të rregullta.

Infrastruktura dhe burimet për zhvillimin e këtij programi janë në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të Fakultetit Filozofik 2018-2023.

Treguesi i performancës 7.2. Një anëtar i senior i stafit është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zhvillimin e infrastrukturës dhe burimeve.

Në kuadër të strukturës menaxheriale të Fakultetit, një prodekan është i emëruar ekskluzivisht si përgjegjës për zhvillimin të infrastrukturës dhe burimeve (Prodekani për çështje materiale).

Treguesi i performancës 7.3. Efektshmëria dhe rëndësia e infrastrukturës dhe burimeve monitorohet rregullisht përmes proceseve që përfshijnë sondazhet e përdorimit dhe kënaqësisë së studentëve. Infrastruktura dhe burimet modifikohen në përgjigje të vlerësimit dhe reagimit.

Prodekani përgjegjës për infrastrukturë dhe burime monitoron në vazhdimësi punën për sa i përket funksionimit të infrastrukturës. Mbi informatat dhe fidbekun që merr, qoftë nga stafi akademik, ai administrativ ose edhe studentët, hartohen plane të intervenimit për ngritjen e cilësisë së infrastrukturës dhe burimeve.

SHTOJCAT

Shtojca 1

Tabela 1. Lista e profesorëve Full Time të përfshirë në këtë program.

Personeli i Përhershëm				Kontrata në bazë të angazhimit - orë në javë			Kontrata mbi norme - orë në javë		Veprimt. Admin./Hulumt.
Nr	Emri mbiemri	Gr. Shk.	Thirrja akad.	Kohezgj. kontrates	Sem. dimeror ligjerata	Semestri veror ligjerata	Sem dimeror/Ligjerata	Sem.Veror ligjerata	
1	2	3	4						
1	Astrit Salihu	Dr.	Prof. Asoc. Dr.	30.09.2017 - dhe me vazhdim automatik njëvjeçar deri në zgjedhje rizgjedhje në konkursin e ardhshëm	6	6	0	0	
2	Hasnije Ilazi	Dr.	Prof. Ass. Dr.	9.6.2021	6	6	6	6	Bartëse e programit MA në filozofi
3	Kristë Shtufi	Dr.	Prof. Ass. Dr.	23.7.2022	6	6	6	6	Shef Departamenti
4	Blerim Latifi	Dr.	Prof. Ass. Dr.	1.6.2019	6	6	0	0	
5	Valon Leci	Dr.	Ass.	1.10.2023	6 Usht rime	0	0	0	Sekretar Departamenti
6	Anton Vukpalaj	Dr.	Prof. Ass. Dr.	12.3.2017 - dhe me vazhdim automatik njëvjeçar deri në zgjedhje ose rizgjedhje në	6	6	6	6	

				konkursin e ardhshëm					
7	Ardian Gola	Dr.	Ass.	5.7.2017 - dhe me vazhdim automatik njëvjeçar deri në rizgjedhje në konkursin e ardhshëm	6	6	6	6	Shef Departame nti i Sociologjis ë

- Fakulteti angazhon me konkurs publik çdo vit një staf të jashtëm akademik me thirrje së paku MA ose doktoranda që mbajnë ushtrimet në lëndët përkatëse, që zakonisht janë 5-7 veta staf junior me kontratë njëvjeçare.

- Prof. Dr. Kadri Metaj që ishte profesor në Departamentin e Filozofisë, nga fundi i semestrit veror 2019 është i pensuar, por është i paraparë për angazhim në Departament për 5 vite me radhë për të mbajtur 4 orë në këtë program.

- Departamenti shpreson që në vitin 2019, në përputhje me nevojat e Departamentit të Filozofisë dhe me Strategjinë për Zhvillimit e Fakultetit Filozofike, të rekrutojë 2 asistentë me kontratë të rregullt pune që mund të mbajnë nga 20 orë ushtrime në secilin semestër.

Shtojca 2 Rekomandimet nga riakreditimi i i fundit i programit Master në Filozofi dhe veprimet e ndërmarra nga Departamenti i Filozofisë

**Departamenti i Filozofisë, Programi MA – Analizë dhe rekomandim
(Riakreditimi i programit ekzistues - Prof. dr. sc. Pavo Barišić)**

1. Rekomandime në lidhje me programin e studimit dhe kurset zgjedhore

Ekipi i vlerësimit konsideron që institucioni i lëndëve zgjedhore ishte një praktikë shumë pozitive, me vlerë për të ruajtur këtë praktikë. Prandaj, do të ishte shumë e dobishme dhe e rekomanduar që cilësia dhe hapja ndërdisiplinore e programit të studimit të zgjidhë barrierat administrative dhe t'umundësojë studentëve të ndjekin kurse zgjedhore në fakultete të tjera të Universitetit të Prishtinës dhe të hyjnë në provime në kuadër të ECTS. Rifutja e kurseve zgjedhore rekomandohet jo vetëm për studimin e filozofisë, por edhe për të gjithë Fakultetin Filozofik si një institucion akademik ndërdisiplinor.

Veprimi 1.

Zbatimi i rekomandimit është kompetencë e zyrës së Rektorit (bazuar në legjislacion) pasi buxheti dhe vendimmarrja Brenda Universitetit të Prishtinës është i centralizuar. Në fakt, bazuar në rregullore, është e mundur që të njohjen ECTS e studentëve nga programet ndërkombëtar e për lëvizshmëri dhe programet (Erasmus +, CEEPUS, Universitetet verore etj.), por jo kurset zgjedhore brenda UP-së.

2.Rekomandime në lidhje me kurrikulën, modulet dhe njësitë (metodologjia e mësimdhënies)

Kundërshtimi kryesor i kurrikulës akademike MA të propozuar është trajnim i pamjaftueshëm në metodologjinë e mësimdhënies. Përkundër faktit se programi i studimit ka deklaruar si qëllim të parë mundësimin e studentëve në mësimin e filozofisë dhe logjikës në shkollat e mesme, si dhe etika dhe edukimi qytetar në arsimin e lartë fillor, nuk ka ndonjë kurs të dedikuar për metodologjinë e të mësuarit të filozofisë. Ekipi i ekspertëve rekomandon fuqishëm prezantimin e kurseve praktike të punës dhe ushtrime në përgatitjen e studentëve për mësimdhënie dhe ligjërata. Përveç mësimit dhe praktikimit të teknikave të mësimdhënies, vlen të rishikohet edhe prezantimi i lëndëve akademike drejt temës së Filozofisë ose Teorisë së Edukimit. Kurse të tilla mund të jenë përfutuese për kurrikulën e studentëve Master, duke bërë të mundur që ata të përgadisnin dhe zhvillojnë mësimdhënie dhe të kuptojnë proceset e të nxënies, si dhe funksionimin e institucioneve arsimore.

Veprimi 2.

Zbatimi i rekomandimit është në kompetencë të rregulloreve të MASHT-it
(**Udhëzim Administrativ nr. 10/2018 të dt. 20/07/2018 (sidheatijtë dt. 13/07/2018).**)

Sipas rregullores, filozofinë, logjikën dhe disiplinat tjera filozofike mund t'i mësojnë vetëm mësuesit që kanë përfunduar MA në fakultetin e Edukimit. Ky është një vendim absurd bazuar në faktin që studentët në Fakultetin e Edukimit nuk kanë ndonjë kurs nga fusha e filozofisë. Departamenti i Filozofisë si dhe Shoqata e Filozofëve të Kosovës kanë kundërshtuar këtë rregullore me letrën e dërguar Ministrin të MASHT dhe Kryeministrin, si dhe gjatë takimit me Ministrin e MASHT, por pa ndonjë rezultat pozitiv.

3. Rekomandime në lidhje me kërkimin shkencor dhe bashkëpunimin ndërkombëtar

Një problem serioz vjen nga fakti që artikujt shkencor të botuar në revistat vendase janë nënvlerësuar. Kriteret për avancimin shkencor të stafit akademik preferojnë botime në revistat e huaja dhe punimet e shkruara në anglisht. Një politikë e tillë shkencore mund të qojë në diskriminimin e shkencëtarëve që botojnë në revistat vendore. Poashtu mund të ketë ndikim negative edhe në zhvillimin e punimeve shkencore vendore dhe në zhvillimin e gjuhës shqipe. Duhet të jetë i ekuilibruar dhe të mbështes zhvillimin e cilësisë dhe përsosurisë së lartë në institucionet shkencore dhe revistat vendore. Fakulteti Filozofik duhet të fillojë ndryshime në politikën shkencore dhe të kërkojë një vlerësim më të mirë të punimit shkencor vendor. Gjithashtu duhet të përpiqet që të përmirësojë strategjinë e vetë të kërkimit shkencor. Universiteti i Prishtinës dhe Qeveria e Kosovës duhet të krijoj një mbështetje të rregullt për kërkime shkencore. Do të jetë thelbësore për zhvillimin e ardhshëm të Departamentit të Filozofisë të përdorë dhe të përqendrohet te burimet shkencore në mënyrë që të sigurojë mjetet e nevojshme financiare për të paguar stafin akademik të rregullt dhe të jashtëm në mënyrë të qëndrueshme. Anëtarët e fakultetit që marrin fonde kërkimore duhet të shpërblehen financiarisht dhe institucionalisht për suksesin e tyre.

Veprimi 3.

Pjesa e rekomandimit për fondet e kërkimit dhe caktimin institucional të stafit akademik për punën e tyre kërkimore nuk është në kompetencën e Departamentit të Filozofisë pasi buxheti dhe vendimmarrja brenda Universitetit të Prishtinës është i centralizuar, përkatësisht varet nga zyra e Rektorit, si dhe dokumentet ligjore. Sidoqoftë, Departamenti i Filozofisë publikoi dy numrat e parë të revistës shkencore AGORA PHILOSOPHIA, dhe po përgatit numrin e tretë. Ndiqma financiare për botim vjen nga buxheti i Fakultetit Filozofik i cili siguron qëndrueshmëri të revistës. Stafi i ri i Departamentit të Filozofisë filloi bashkëpunimin e ngushtë me Departamentin e Filozofisë në Zagreb në një mënyrë për të siguruar indeksimin ndërkombëtar të revistës.

Sipas çështjes së kërkimit, Fakulteti Filozofik miratoi Strategjinë për Zhvillimin e Fakultetit Filozofik 2018-2021 ku adresohen çështjet kryesore të kërkimit shkencor, si dhe buxheti. Sidoqoftë, buxheti ende mungon (duke pritur vendimin nga zyra e Rektorit), dhe iniciativat individuale nga stafi akademik janë të rralla për t'u mbështetur dhe nuk njihen mirë nga zyra e Rektorit

Nga viti 2016 Departamenti i Filozofisë është pjesë e programit CEEPUS përmes rrjetit

ndërkombëtar *Filozofia dhe Interdisiplinariteti*. Stafit akademik, si dhe studentët e BA dhe MA përfitojnë nga ky program përmes lëvizshmërisë dhe vizitave në universitete evropiane dhe universitete në rajon. Kjo është një mundësi shumë e mirë sidomos për studentët për të bërë hulumtime mbi tema që mbulojnë temat e tyre të BA dhe MA. Në të njëjtën kohë studentët përmirësojnë nivelin e gjuhëve të huaja.

4. Rekomandime në lidhje me stafin mësimor dhe nivelet e studimit

Ekipi i ekspertëve rekomandon fuqishëm që Fakulteti të mbështesë Departamentin e Filozofisë në rritjen e duhur të kapaciteteve mësimore dhe strategjisë zhvillimore. Këshilla primare është krijimi dhe fuqizimi i një plani të qartë karriere për punonjësit në Fakultet në të cilin kualifikimet e tyre akademike, lista e botimeve, praktika mësimore, veprimtaritë mësimore dhe aftësitë gjuhësore do të shpërblehen si duhet. Stafit mësimor duhet të ketë kohë të mjaftueshme për hulumtimet e tyre dhe bashkëpunim ndërkombëtarë. Fakulteti duhet qartë të rris numrin e stafit mësimor në një marrëdhënie të përshtatshme me numrin e studentëve. Është veçanërisht e rëndësishme për krijimin e dëshirueshëm e programit pasuniversitar të doktoratës që është propozuar tashmë nga Departamenti i Filozofisë.

Veprimi 4

Zbatimi i rekomandimit është në kompetencë të zyrës së Rektorit (bazuar në legjislacion) pasi buxheti dhe vendimmarrja brenda Universitetit të Prishtinës është i centralizuar. Së fundmi, Fakulteti Filozofik miratoi Strategjinë për Zhvillimin e Fakultetit Filozofik 2018-2023, pjesë e së cilës është edhe punësimi i stafit të ri. Bazuar në dokumentin strategjik, Departamenti i Filozofisë duhet të punësoj 3 anëtarë të stafit të lartë dhe 4 anëtarë të rinjë në 4 vitet e ardhshme. Sidoqoftë, zbatimi i Strategjisë varet nga vendimi i zyrës së rektorit për të hapur thirrje për vende të reja pune.

Bazuar në Strategjinë për Zhvillimin e Fakultetit Filozofik 2018-2023, Departamenti i Filozofisë është në proces përgatitjeje për programin e përbashkët të nivelit të doktoratës (PhD në Shkencat Sociale dhe Shkencat Humane) me departamentet e Sociologjisë dhe Shkencave Politike. Propozimi do të procedohet për procedurën e akreditimit gjatë vitit 2020. Departamenti i Filozofisë nuk mund të plotësojë me lehtësi kërkesat e përcaktuara për futjen e programit të studimit të Doktoratës pa punësime të reja.

4. Rekomandimet në lidhje me lehtësirat

Fakulteti Filozofik siguron projekte të financuara për botimin e teksteve shkollore. Rekomandohet gjithashtu që të t r melohetjé program sistematik për furnizim me literaturë të huaj si dhe me përkthimin e veprave madhore në fushat mësimore në gjuhën shqipe, jo vetëm nga përkthyes profesional, por edhe nga ekspertë e akademikë të specializuar në këto degë shkencore

Veprimi 5.

Zbatimi i rekomandimit është në kompetencë të zyrës së Rektorit (bazuar në legjislacion) pasi buxheti dhe vendimmarrja brenda Universitetit të Prishtinës është i centralizuar.

Në fakt, jo vetëm përkthimet e librave, por edhe botimi i librave universitar në gjuhën shqipe nuk mbështeten financiarisht nga zyra e Rektorit, pavarësisht rregullores ekzistuese për botimet nën logon e UP. Botimi i librave universitar është i mundur vetëm përmes vetëfinancimit.